


# Kumbona e së Diellës



GËZUAR KRISHTLINDJEN DHE VËTIN E RI 2021



KRYEDIOQEZA METROPOLITANE SHKODËR - PULT  
Nr.11/12, Nëntor - Dhjetor 2020



## DRITA E KRISHTIT I JEP FORMË DHE NGJYRË KËTIJ REALITETI

### Përshumëvjet Krishtlindjen 2020

Mbërriti koha e hareshë, dita e festës për të përkujtuar ngjarjen që ka ndryshuar botën: lindjen e një Fëmije, që përmbledh në vetvete njerëzinë tonë, vizituar prej Zotit dhe Krijuesit të të gjitha gjërave, me qëllim që ta shpëtojë atë. Një ngjarje unike dhe përfundimtare, që realizohet çdo ditë, deri në fund të kohëve, për ata që e mikpresin këtë prani të përvuajtë dhe të fuqishme të Fëmijës së Betlehemit, të Zotit dhe të Shpëtimtarit tonë.

Këtë herë, për fat të keq, kujtimi i Lindjes së Jezu Krishtit shënohet prej vuajtjes fizike dhe psikologjike, që pandemia ka shkaktuar në krejt planetin tonë, një hije e zezë që dritat e festat me zor arrijnë ta largojnë.

Edhe këtë vit, do të vijë momenti kur do të fiken dritat e zbukurimeve, por nuk do të fiket drita e shpresës të ai që nuk do të jetë ndalur vetëm te aspektet e jashtme të kësaj feste. Ai që, i shtyrë prej fesë, ndërsa do ta ketë pranuar Jezusin si “dritën e vërtetë që shndrit çdo njeri” (krh. Gjn 1, 9) do të vazhdojë ta shijojë këtë dritë edhe kur do të fiken të gjitha dritat e tjera. Ai që ngrohet prej kësaj Drite, nuk i druhet të ftohtit që lë çdo kthim në normalitet, pasi e di se do të ngrohet prej burimit të shpresës.

Drita e Krishtit nuk verbon me arrogancë, siç bëjnë dritat tona artificiale, për të na larguar prej të përditshmes sonë dhe për të na bërë që të humbasim kontaktin me realitetin e jetës sonë, edhe kur ai është i trishtë dhe i dhimbshëm, por Drita e Krishtit i jep formë dhe ngjyrë këtij realiteti, edhe kur ai është i trishtë dhe i dhimbshëm, me qëllim që me shikimet tona ta përkëdhelim me butësi dhe dhembshuri atë.

Në fakt, shpresa e vërtetë, nuk është qorre: por, ndërsa dallon realitetin e dhimbjes, di t'i kërkojë ndihmë fesë për ta lexuar këtë realitet me sytë e Hyjit, që janë sytë e një Ati të mirë dhe të mëshirshëm; di t'i drejtohet dashurisë që na vë në lëvizje për t'u kujdesur për veten tonë dhe për të tjerët me të njëjtën dashuri me të cilën Hyji kujdeset për të gjithë ne.

Urimi im për këtë Krishtlindje të Zotit 2020 është që kremtimi i kësaj feste, ndërsa na kujton “Kush është Jezusi që kremtojmë”, na bëftë që të rritemi në shpresë, për ta parë pa ankth këtë moment kaq të vështirë që jemi duke kaluar; na bëftë të fortë në fe, për ta përballuar këtë moment me besimin e atij që vë çdo siguri në Provaninë e Hyjit dhe në fuqinë e tij; na bëftë punëtorë të dashurisë, nëpërmjet respektit ndaj të afërmit dhe përkujdesjes ndaj sigurisë së tij, si dhe nëpërmjet veprave të mëshirës shpirtërore dhe trupore.


Një mendim të veçantë ua drejtoj të gjithë atyre që po vuajnë për shkak të kësaj sëmundjeje në shtëpi apo në spital, të humbjes së njerëzve të tyre të afërm, të vështirësive të tyre ekonomike që rrjedhin nga pandemia; në lidhje me këtë, një ftesë të veçantë dua t'ua drejtoj të gjithë atyre që jetojnë me tregti, me qëllim që të mos e vështirësojnë këtë situatë duke ngritur çmimet, sidomos të mallrave të nevojës së parë.

Kujtoj në lutjen time personat e moshuar dhe të vetmuar, si dhe të burgosurit që të mos e humbasin shpresën për një jetë më të mirë dhe më të virtytshme. Përsëritës politikantët dhe qeveritarët e Shtetit tonë, në nivelin Qendrorë dhe Vendore, duke i ftuar të gjithë që të jenë shembull për interesimin që duhet të tregojnë ndaj të mirës së përbashkët dhe ndaj më nevojtarëve, si edhe ftoj të gjithë burrat e gratë e kulturës, të cilët i ftoj që ta duan këtë popull duke bashkëndarë dhe duke përçarur jo vetëm informacione, por edhe pasion për të bukurën dhe të mirën.

Për secilin prej jush i kërkoj Jezusin Fëmijë çdo hir e bekim prej Qiellit: Ai që është Hiri i Hyjit shfaqur në botë (krh. Tit 2, 11) realizoftë në secilin prej nesh shpëtimin që ka sjellë me Lindjen e Vet.

Urime të gjithëve.

+ Angelo Massafra OFM  
Arqipeshkëv





|                                                                        |    |
|------------------------------------------------------------------------|----|
| Papa Françesku<br>DITA IV BOTËRORE E TË VARFËRVE                       | 4  |
| Mons. Angelo Massafra O.F.M.<br>TË GJITHË JU MESHTARËVE, RREGULLTARËVE | 7  |
| Moter Marjeta Gjoka<br>MISTERI I MADH I DASHURISË                      | 8  |
| Don Nosh Gjollaj<br>CIKLI I NATËS DHE AI I DITËS                       | 11 |
| Dom Lush Gjergji<br>FAMILJA DHE EDUKIMI I ADOLESHENTËVE                | 13 |
| Johan Verschueren<br>RRJEDHJA E BESIMIT                                | 15 |
| Zyra e Shtypit e KISH<br>NUNCI I RI APOSTOLIK                          | 19 |
| Dom Nikë Ukgjini<br>KISHA MESJETARE SHËN BARBARËS                      | 20 |
| Imzot Angelo Massafra OFM<br>NJË HUMANIZËM PA ZOTIN                    | 22 |
| Angelo Massafra O.F.M.<br>MBYLLJA E KISHAVE E XHAMIVE                  | 24 |
| Motrat Stigmatine<br>JUBILEU I TË LUMES MARIE TUCI                     | 25 |
| Moter Mandalena Lepuri e Moter Rita Toma<br>KRISHTI NA KA THIRRUR      | 26 |
| Marjan Gjinesha<br>SHËRBESA E LEKTORATIT                               | 26 |
| Motër Ema<br>INAUGURIMI NË KISHËN MJESJETARE<br>TË SHËN BARBARËS       | 27 |

## KUMBONA E SË DIELLËS

Viti XXXIII, nr. 11/12 (537 - 538) Nëntor - Dhjetor 2020

Revistë  
Fetaro-Kulturore  
Drejtues  
Imzot Angelo MASSAFRA

Redaksia  
Dom Nikë Ukgjini (Kryeredaktor)  
Dom Vlash Palaj  
Dom Gjovalin Simoni

Adresa:  
Arqipeshkvia Shkodër  
Sheshi Gjon Pali II  
Tel. 0222-42764  
Fax. 0222-43673  
e-mail: n\_ukgjini@yahoo.it  
Web page: kishakatolikeshkoder.com

Redaktor teknik: Xhon Nika

KRYEDIOQEZA METROPOLITANE SHKODËR - PULT





## MESAZHI I ATIT TË SHENJTË FRANÇESKO

**DITA IV BOTËRORE E TË VARFËRVE***E diela XXXIII e Kohës së Rregullt**15 nëntor 2020***“Shtrija dorën të varfrit” (cfr Sir 7,32)**

“Shtrija dorën të varfrit” (cfr Sir 7,32). Urtësia e lashtë i ka sjellë këto fjalë si një rregull i shenjtë për tu ndjekur në jetë. Sot këto fjalë janë më aktuale se kurrë. Ato na ndihmojnë ta përqendrojmë shikimin tek gjërat thelbësore dhe të kapërcejmë pengesat e indiferencës. Varfëria gjithmonë shfaqet në pamje të ndryshme, dhe kërkon vëmendje ndaj çdo situatë të veçantë: tek secila prej tyre mund të takojmë Jezusin Zot, që ka treguar se është i pranishëm tek vëllezërit e tij më të dobët (cfr Mt 25,40).

1. Le të marrim në dorë librin e Sirach, një nga librat e Testamentit të Vjetër. Këtu gjejmë fjalët e një mësuesi të urtë, i cili ka jetuar rreth dyqind vjet para Krishtit. Ai kërkonte urtësinë që i bën njerëzit më të mirë dhe të aftë të depërtojnë në çështjet e jetës. Këtë ai e ka bërë në një kohë prove të vështirë për popullin e Izraelit, në një kohë dhimbjeje, pikëllimi dhe varfërie për shkak të mbizotërimit të fuqive të huaja. Duke qenë një njeri me besim të madh, tek i cili ishin rrënjësuar traditat e etërve, gjëja e parë që i shkoi në mendje ishte ti drejtohej Zotit për ti kërkuar Atij dhuratën e urtësisë. Dhe Zoti nuk ia refuzoi ndihmën e vet.

Që në faqet e para të librit, Sirach paraqet këshillat e tij në lidhje me shumë situata konkrete të jetës, dhe varfëria është një prej tyre. Ai këmbëngul që dhe në vështirësi duhet të vazhdojmë të besojmë në Zot: “Mos e humb kur je në sprovë. Qëndro pranë tij pa u shkaputur, në mënyrë që të lartësohesh në fund të ditëve të tua. Prano atë që të ndodh dhe jë i duruar në ngjarjet e dhimbshme, sepse floriri provohet me zjarr dhe njerëzit e zgjedhur në furrën e dhimbjes. Në rast sëmundjeje dhe në varfëri beso tek ai. Mbështetu tek ai dhe ai do të të ndihmojë, ec në rrugë të drejtë dhe shpresë tek ai. Ju që e keni frikë Zotin, prisni mëshirën e tij dhe mos devijoni, për të mos u rrëzuar” (2,2-7).

2. Faqe pas faqe zbulojmë një përmbledhje të çmuar sugjerimesh se si të reagojmë ndaj dritës së një marrëdhënieje të ngushtë me Zotin, krijues dhe dashurues i krijimit, i drejtë dhe i matur me të gjithë bijtë e tij. Megjithatë, referimi i vazhdueshëm tek Zoti nuk të largon nga të parit e njeriut konkret, përkundrazi, të dyja këto janë të lidhura ngushtë me njëra tjetrën.

Pasazhi nga i cili është marrë titulli i këtij Mesazhi e tregon qartë këtë (cfr. 7: 29-36). Lutja ndaj Zotit dhe solidariteti me të varfërit dhe të vuajturit janë të pandashme. Për të kryer një veprim adhurimi të



pëlqyeshëm për Zotin, është e nevojshme të pranojmë se çdo person, madje edhe më i varfëri dhe i përcmuari, mbart imazhin e Zotit të ngulitur në të. Nga kjo vëtedije rrjedh dhurata e bekimit hyjnor, e tërhequr nga bujaria e praktikuar ndaj të të varfërve. Prandaj, koha që i kushtohet lutjes nuk mund të bëhet kurrë një justifikim për të lënë pas dore fqinjin në vështirësi. E kundërta është e vërtetë: bekimi i Zotit zbret mbi ne dhe lutja arrin qëllimin e saj kur shoqërohen nga shërbimi ndaj të varfërve.

3. Sa aktual është dhe për në ky mësim i lashtë! Në fakt, Fjala e Zotit shkon përtej hapësirës, kohës, feve dhe kulturave. Bujaria që mbështet të dobëtin, ngushëllon të pikëlluarin, qetëson vuajtjet, i kthen dinjitetin atyre që i është privuar, është kusht i një jete plotësisht njerëzore. Zgjedhja për t'i kushtuar vëmendje të varfërve, nevojave të tyre të shumta dhe të ndryshme, nuk mund të kushtëzohet nga koha në dispozicion apo nga interesa private, as nga projekte të papërcaktuara baritore ose sociale. Fuqia e hirit të Zotit nuk mund të mposhtet nga tendenca egoiste për ta vendosur gjithmonë veten në radhë të parë.

Është e vështirë ta mbash vështrimin nga i varfri, por shumë e nevojshme për ti dhënë jetos tonë personale e sociale drejtimin e duhur. Nuk është çështje fjalësh, por është një angazhim konkret i frymëzuar nga bamirësia hyjnore. Çdo vit, me Ditën Botërore të të Varfërve, unë kthehem në këtë realitet themelor për jetën e Kishës, sepse të varfërit janë dhe do të jenë gjithmonë me ne (cfr Gv 12, 8) për të na ndihmuar të mirëpresim praninë e Krishtit në jetën e përditshme.

4. Gjithmonë takimi me një person në kushte varfërie na provokon dhe na bën të mendojmë. Si mund të kontribuojmë për të eliminuar ose të paktën



për të zbutur marginalizimin dhe vuajtjen e tij? Si mund ta ndihmojmë në varfërinë e tij shpirtërore? I bëhet thirrje komunitetit të krishterë të përfshihet në këtë përvojë të bashkëndarjes, i vetëdijshëm se nuk i lejohet t'ia delegojë të tjerëve. Dhe për të mbështetur të varfërit është thelbësore ta jetojmë vetë varfërinë ungjillore. Nuk mund të ndihemi "në rregull" kur një anëtar i familjes njerëzore lihet mënjanë dhe bëhet hije. Thirrja e heshtur e shumë të varfërve duhet ti gjejë njerëzit e Zotit në ballë, gjithmonë dhe kudo, për t'i dhënë atyre një zë, për t'i mbrojtur dhe për tu solidarizuar me ta përballë kaq shumë hipokrizie e premtimesh të përcaktuara, dhe për ti ftuar të marrin pjesë në jetën e komunitetit.

Është e vërtetë, Kisha nuk ka zgjidhje gjithëpërfshirëse për të propozuar, por ofron, me hirin e Krishtit, dëshminë e saj dhe gjestet e bashkëndarjes. Për më tepër, ajo ndihet e detyruar të paraqesë kërkesat e atyre që nuk kanë minimumin e nevojshëm për të jetuar. Ti kujtosh të gjithëve vlerën e madhe të së mirës së përbashkët është një angazhim jetësor për popullin e krishterë, i shprehur në përpjekjen për të garantuar që asnjë nga ata, të cilëve u është shkëlur dinjiteti njerëzor në nevojat e tij themelore, nuk do të harrohet.

5. Zgjatja e dorës e bën të qartë, para së gjithash për ata që e bëjnë, se brenda nesh ekziston aftësia për të kryer veprime që i japin kuptim jetës. Sa duar të shtrira shihen çdo ditë! Fatkeqësisht, gjithnjë e më shpesh ndodh që nxitimi të na tërheqë në një vorbull indiference, deri në atë pikë sa të mos dimë më të dallojmë të mirën e madhe që bëhet çdo ditë në heshtje dhe me një zemërgjerësi të madhe. Kështu ndodh që, vetëm kur ndodhin ngjarje që prishin rrjedhën e jetës sonë, sytë tanë bëhen të aftë të dallojnë mirësinë e shenjtoreve "në portën ngjitur", "të atyre që jetojnë afër nesh dhe janë një pasqyrim i pranisë së Zotit" (Nxitja Apostolike Gaudete et exsultate, 7), por për të cilën askush nuk flet. Lajmet e këqija mbushin faqet e gazetave, faqet e internetit dhe ekranet e televizioneve, aq sa duket se sundon e keqja mbi çdo gjë. Nuk është kështu. Sigurisht, nuk mungon ligësia dhe dhuna, abuzimi dhe korrupsioni, por jeta është e ndërthurur me vepra respekti dhe bujarie që jo vetëm kompensojnë të keqen, por dhe na shtojnë të shkojmë më tej dhe të jemi plot shpresë.

6. Shtrirja e dorës është një shenjë: një shenjë që menjëherë të kujton afërsinë, solidaritetin, dashurinë. Në këto muaj, kur e gjithë bota është tronditur nga një virus që ka shkaktuar dhimbje dhe vdekje, dëshpërim dhe hutim, sa duar të shtrira kemi mundur të shohim! Dora e shtrirë e mjekut që kujdeset për çdo pacient duke u përpjekur të gjejë mjekimin e duhur. Dora e shtrirë e infermieres dhe infermierit të cilët kujdesen për të sëmurët përtej orarit të tyre të punës. Dora e shtrirë e atyre që punojnë në administratë dhe sigurojnë mjetet për të shpëtuar sa më shumë jetë.

Dora e shtrirë e farmacistit që ekspozohet ndaj shumë kërkesave në një kontakt të rrezikshëm me njerëzit. Dora e shtrirë e priftit që bekon me zemër të thyer. Dora e shtrirë e vullnetarit që ndihmon ata që jetojnë në rrugë dhe shumë të tjerë që, megjithëse e kanë një strehë, nuk kanë asgjë për të ngrënë. Dora e shtrirë e burrave dhe grave që punojnë për të ofruar shërbime thelbësore dhe siguri. Dhe mund të përshkruajmë akoma duar të tjera të shtrira derisa të krijojmë një litani veprash të mira. Të gjitha këto duar kanë sfiduar ngjitjen e virusit dhe frikën në mënyrë që të japin mbështetje dhe shpëtim.

7. Kjo pandemi erdhi papritur dhe na gjeti të papërgatitur, duke shkaktuar një ndjesi të fortë çorientimi dhe pafuqie. Megjithatë, dora që i shtrihet të varfërit nuk erdhi papritur. Përkundrazi, ajo ofron dëshminë se si të përgatitemi për të njohur të varfrin që ta mbështesim atëherë kur ka nevojë. Mjetet e mëshirës nuk improvizohen. Nevojitet një trajnim i përditshëm që nisët nga vetëdija se sa, ne të parët, kemi nevojë për një dorë të shtrirë drejt nesh.

Ky moment që po përjetojmë ka vënë në krizë shumë siguri tonat. Ndjehe mi të varfër dhe më të dobët sepse kemi provuar ku i kemi kufinj të tanë dhe kufizimin e lirisë. Humbja e punës, e mundësisë për të qenë pranë të dashurve dhe të njohurve tanë papritmas kanë hapur horizonte që nuk ishim mësuar t'i vëzhgonim më. Pasuritë tona shpirtërore dhe materiale u vunë në dyshim dhe kuptuam se kemi frikë. Të mbyllur në heshtjen e shtëpive tona, kemi rizbuluar se sa e rëndësishme është thjeshtësia dhe përqendrimi ynë tek gjërat thelbësore. Kemi kuptuar nevojën për një vëllazëri të re, të aftë për ndihmë reciproke dhe respekt të ndërsjellë. Kjo është koha e përshtatshme për të "ndjerë përsëri se kemi nevojë për njëri-tjetrin, se kemi përgjegjësi ndaj të tjerëve dhe ndaj botës [...]. Për një kohë tepër të gjatë kemi qenë në degradim moral, duke u tallur me etikën, mirësinë, besimin, ndershmërinë [...]. Ky shkatërrim i çdo themeli të jetës shoqërore na kthen kundër njëri-tjetrit për të mbrojtur interesat tona, provokon shfaqjen e formave të reja të dhunës e mizorisë dhe parandalon zhvillimin e një kulture të vërtetë të kujdesit për mjedisin" (Lett. enc. Laudato si', 229). Me pak fjalë, krizat serioze ekonomike, financiare dhe politike nuk do të kenë fund për sa kohë të lejojmë që përgjegjësi që të gjithë duhet të ndiejmë ndaj njëri-tjetrit të mbetet në letargji.

8. Pra, "shtrirja e dorës të varfrit", është një ftesë për përgjegjësi si një angazhim i drejtpërdrejtë i çdokujt që ndihet se është pjesë e të njëjtit fat. Është një nxitje për të marrë barrën e më të dobët, siç kujton Shën Pali: "Përmes dashurisë, jini në shërbim të njëri-tjetrit. Në fakt, i gjithë ligji plotësohet në një këshill të vetme morale: Duaje të afërmin tënd si veten. [...] Mbani barrën e njëri-tjetrit" (Gal 5, 13-14; 6,2). Apostulli na mëson se liria që na u dha me



vdekjen dhe ringjalljen e Jezu Krishtit është për secilin prej nesh një përgjegjësi për tu vënë në shërbim të të tjerëve, veçanërisht të më të dobëtve. Kjo nuk është një këshillë fakultative, por një kusht i vërtetësisë së besimit që ushtrojmë.

Libri i Sirach na vjen sërish në ndihmë: sugjeron veprime konkrete për të mbështetur më të dobët dhe gjithashtu përdor disa pamje sugjestionuese. Së pari mendon për dobësinë e atyre që janë të trishtuar: "Mos i shmang ata që qajnë" (7,34). Periudha e pandemisë na ka detyruar të izolohehi, madje duke na ndaluar që të ngushëllojmë dhe të jemi pranë miqve dhe të njohurve të brengosur nga humbja e të dashurve të tyre. Gjithashtu autori i shenjtë thotë: "Mos hezitoni të vizitoni një të sëmurë" (7,35). Kemi provuar pamundësinë për të qenë pranë atyre që vuajnë, dhe në të njëjtën kohë kemi kuptuar brishtësinë e ekzistencës sonë. Me pak fjalë, Fjala e Zotit nuk na lë kurrë të qetë dhe vazhdon të na stimulojë që të bëjmë mirë.

**9.** Nga ana tjetër, thirrja "Shtrija dorën të varfrit" nxjerr në pah sjelljen e atyre që mbajnë duart në xhepa dhe nuk preken nga varfëria, për të cilën shpesh janë dhe bashkëpunëtorë. Mospërfillja dhe cinizmi janë ushqimi i tyre i përditshëm. Çfarë ndryshimi në krahasim me duart bujare që kemi përshkruar! Në fakt, ka duar që shtrihen për të prekur shpejt një tastierë kompjuteri dhe për të lëvizur shuma parash nga një pjesë e botës në tjetrën, duke përligjur pasurinë e një oligarkie të ngushtë dhe mjerimin e turmave ose dështimin e kombeve të tëra. Ka duar të shtrira për të mbledhur para duke shitur armë që të tjera duar, përfshirë ato të fëmijëve, do ti përdorin për të mbjellë vdekje dhe varfëri. Ka duar të shtrira që në hije shkëmbejnë doza vdekjeje për t'u pasuruar dhe për të jetuar në luks dhe tepri. Ka duar të shtrira që poshtë tavolinës shkëmbejnë favore të paligjshme për përfitime të lehta dhe korruptive. Dhe ka edhe duar të shtrira që me respekt hipokrit vendosin ligje që ata vetë nuk i respektojnë.

Në këtë panoramë, «të përjashtuarit vazhdojnë të presin. Për të pasur një mënyrë jetese që përjashton të tjerët, ose për tu ngazëllyer me këtë ideal egoist, është zhvilluar një globalizim i indiferencës. Pothuajse pa e kuptuar, bëhemi të paaftë për të ndjerë dhembshuri përballë thirrjes nga dhimbja e të tjerëve, nuk qajmë më përpara dramës së të tjerëve dhe as nuk na intereson të kujdesemi për ta, sikur gjithçka të ishte një përgjegjësi e huaj, që nuk na takon ne".

Nuk do të mund të jemi të lumtur derisa këto duar që mbjellin vdekjen të shndërrohen në instrumente të drejtësisë dhe paqes për të gjithë botën.

**10.** "Në çdo veprim tëndin, kujto fundin/qëllimin tënd" (Sir 7,36). Kjo është shprehja me të cilën Sirach

përfundon reflektimin e tij. Kjo mund të ketë dy interpretime. I pari tregon që duhet të kemi gjithnjë parasysh fundin e ekzistencës tonë. Të kujtojmë fatin e përbashkët mund të na ndihmojë për të bërë një jetë kushtuar vëmendjes ndaj atyre që janë më të varfër dhe nuk kanë pasur të njëjtat mundësi si ne. Ekziston edhe një interpretim i dytë, i cili thekson më tepër qëllimin drejt të cilit priren të gjithë. Është qëllimi i jetës tonë që kërkon një projekt për tu realizuar dhe një rrugëtim për tu përfunduar pa u lodhur. E qëllimi i të gjitha veprimeve tona nuk mund të jetë gjë tjetër veç dashurisë. Ky është qëllimi drejt të cilit jemi drejtuar dhe asgjë nuk duhet të na tërheqë vëmendjen prej tij. Kjo dashuri është bashkëndarje, përkushtim dhe shërbim, por nis me zbulimin se ne fillimisht jemi dashur dhe jemi zgjuar për të dashur. Ky qëllim shfaqet kur fëmija përballlet me buzëqeshjen e nënës dhe ndihet i dashur për vetë faktin e ekzistencës së tij. Edhe një buzëqeshje që ndajmë me të varfrin është një burim dashurie dhe na lejon të jetojmë në gëzim.



Atëhere, dora e shtrirë, u pasuroftë gjithmonë nga buzëqeshja e atyre që nuk e peshojnë praninë e tyre dhe ndihmën që ofrojnë, por vetëm gëzohen duke jetuar sipas mënyrës së dishepujve të Krishtit.

Në këtë rrugëtim të takimit të përditshëm me të varfërit na shoqëron Nëna e Zotit, e cila më shumë se kushdo tjetër është Nëna e të varfërve. Virgjëresha Mari i njeh nga afër vështirësitë dhe vuajtjet e atyre që janë të marginalizuar, sepse ajo vetë nxori në dritë Birin e Zotit në një stallë. Për shkak të kërcënimit të Herodit, ajo iku me burrin e saj Jozefin dhe Jezusin e vogël në një vend tjetër dhe për disa vite Familja e Shenjtë jetuan si refugjatë. Lutja jonë drejtuar Nënës së të varfërve i bashkoftë bijtë e saj të dashur me të gjithë ata që u shërbejnë atyre në emër të Krishtit. Dhe lutja e shndërroftë dorën e shtrirë në një përqaftim vëllazërie të përbashkët dhe të rigjetur.

*Romë, San Giovanni in Laterano, 13 qershor 2020, Përkujtimore liturgjike e Shën Antonit të Padovas.*





Prot. n. 172/2020  
Shkodër, 27/11/2020

***Të gjithë ju meshtarëve, rregulltarëve/eve  
dhe besimtarëve të Arqidioqezës Shkodër-Pult***

Zoti ju dhashtë paqe!

Në fillim të këtij viti të ri liturgjik, që shënon Koha e Ardhjes, dëshiroj t'ju vizitoj me këtë letër, i bindur se momenti historik që jemi duke jetuar ka nevojë që të lexohet në dritën e fesë.

Dhe është pikërisht në dritën e fesë që këtij skenari apokaliptik, me të cilin jemi mësuar prej gati një viti me “boletinet epidemiologjike” të tij të përditshme, nuk duhet t'ia lejojmë që të na e vjedhë shpresën.

Pikërisht shpresa është virtyti i kësaj Kohe të fortë të Ardhjes: kohë reflektimi mbi “*qiell të ri e një tokë të re*” kumtuar nga Zbulesa (Zb 21, 1), kohë për të ripërtërirë në ne dëshirën që të vijë Zoti Jezus me thirrjen “Maranathà”, “Eja, o Zot Jezus”, kohë për të kujtuar dhe për të kremtuar ngjarjen historike të lindjes së Shpëtimtarit tonë në gëzimin e Krishtlindjes.

Shumë të dashur, *qielli i ri e toka e re* nuk jepen pa kaluar nëpër “*mundime*” (Zb 12). Kjo pandemi globale është një ngjarje shkatërruese, që është duke mbjellë viktima kudo nëpër glob, si edhe në Shqipëri: mund të ndalemi që ta shohim në aspektet e saj shkatërruese; mund edhe ta trajtojmë me sipërfaqësi apo fatalizëm; apo mund të mikpresim ftesën e Papa Françeskut për të mos e çuar dëm këtë krizë (Homelia e Rrëshajës 2020).

Ajo përfaqëson mundësinë për ne besimtarët që të bëhemi të afërm të kujdesshëm me të gjithë ata persona që, për shkak të pandemisë, kanë humbur personat e dashur, vdekur për shkak të sëmundjes apo sepse ia kanë hequr jetën vetes, me të sëmurët që aktualisht janë duke luftuar me këtë virus, me ata që kanë humbur punën apo kanë më pak punë për shkak të masave shtrënguese, me ata që nuk mund të bëjnë atë jetë shoqërore me të cilën ishin mësuar në punë, në shkollë apo thjesht në kohën e lirë. Është mundësia për të mbledhur klithmën e dhunave që janë ashpërsuar, të gjendjeve të vështira psikologjike dhe shoqërore subjekt i të cilave jemi edhe ne vetë, të prishjeve të familjeve, etj.

Si mund të bëhemi i afërmi i tyre? Me siguri me një lutje të kujdesshme dhe plot besim. Të gjithë kemi mundësi të themi një “Maranathà”, “Eja, o Zot Jezus”. Por pandemia na ka kufizuar edhe në këtë gjë, duke na detyruar që t'i bëjmë shtëpitë tona çenakuj lutjeje: a e kemi parë këtë mundësi? Me siguri lutja në kishë është ajo më realja dhe më e ndiera, por edhe “kisha shtëpiake” është një mundësi që mund ta vlerësojmë, sidomos për të moshuarit dhe për ata që kanë frikë se mos infektohen apo për ata që nuk duan t'i vënë në rrezik të tjerët.

Një mënyrë tjetër për t'u bërë i afërm është ajo që të jemi të gatshëm për t'i plotësuar nevojat materiale të më nevojtarëve, duke u bërë ne vetë motiv shprese për të tjerët. Por që një gjë e tillë të realizohet është e nevojshme që të kemi një shikim të hapur dhe të



vëmendshëm ndaj botës që na rrethon dhe jo të përqendruar te vetja jonë dhe te nevojat tona. Të mos i lëmë vetëm të moshuarit, t'i ndihmojmë invalidët që të sigurojnë ushqimin e nevojshëm, t'i inkurajojmë të dobëtit, t'i nisim të rinjtë, t'ua bëjmë të gëzuara ditët fëmijëve.

Në fund, besoj se mund të bëhemi të afërm edhe përmes respektimit të të gjitha normave higjieno-sanitare të rekomanduara prej organeve përkatëse shtetërore dhe zbatimit të udhëzimeve të dhëna prej Ispeshkvinjve.

Të dashur, është detyrë morale të mbrojmë veten dhe të tjerët nga e keqja, në çfarëdo forme që ajo të paraqitet.

Vëllezër e motra, e ardhmja është edhe në duart tona. Ne sot mund t'i shkruajmë faqet e bardha të historisë, që provania e Hyjit na beson: neve na takon detyra për t'i mbushur ato me Ungjillin e gjallë apo me zgjedhje që nuk kanë shpresë, dashuri dhe solidaritet vëllazëror. Le ta tregojmë me vepra fenë që kemi në zemër, sepse Jezu Krishti ka thënë: “*Nëse e doni njëri-tjetrin, të gjithë do t'ju njohin se jeni nxënës të mi*” (Gjn 13, 35).

Ju shpreh afërsinë time të gjithëve ju, në mënyrë të veçantë të sëmurëve, të moshuarve dhe të gjithë atyre që janë duke vuajtur prej kësaj pandemie. Ju ftoj të gjithëve në shpresën dhe në pritjen e gëzueshme të Zotit, në lutjen e bërë me zemër “Maranathà”, në veprat e dashurisë vëllazërore, që shprehin besnikërinë tonë ndaj Krishtit.

Të gjithëve ju bekoj me zemër.

Arqipeshkvi juaj

† **Angelo Massafra O.F.M.**



**Moter Marjeta Gjoka**

*Punëtore e Vogel e Zemrave të Shenjta*

### **MISTERI I MADH I DASHURISË, MISHËRIMI I BIRIT TË HYJIT**

*“E Fjala u bë njeri e banoi ndër ne” (Gjn 1, 14)*

E adhurojmë me besim të thellë Fjalën e bërë mish, e cila është shumëpritur nga njerëzit, Shpëtimtari i botës.

Reflektojmë mbi këtë mister të pranisë së gjallë të “Hyjit me ne”, i cili është bërë i vogël dhe i varfër dhe nuk ka hezituuar të merrte mbi vete brishtësinë

thotë që, «[...]në mesin tënd është Zoti Hyji yt, trim mbi trima Shpëtimtar! Do të gadojë për ty hareshëm, i përmallur nga dashuria, do të kërcejë për ty me gëzim pors i në ditë feste[...]», (Sof 3, 16 - 18). Na duhet të jemi të kujdesshëm për të soditur këtë mister, i cili ka ardhur në mesin tonë për të na



dhe dobësinë tonë, për ti manifestuar njeriut dashurinë e tij të pamasë. Ai hyri në historinë njerëzore për ta ndriçuar atë, për ta orientuar, për ta shpëtuar, dhe për të sjellur shpresën që bota ka nevojë aq shumë. Falë Marisë e cila iu hap hirit të Hyjit dhe bashkëpunoi me vullnetin e Tij, duke e mikpritur Fjalën e cila mishërohet në krahë të saj, Biri i Hyjit hyn në historinë njerëzore duke na manifestuar imazhin e vërtetë të qenies tonë njerëzore. Për këtë e kemi të qartë që për të folur dhe për të mikpritur këtë mister në zemrat tona, duhet ti drejtohem Marisë model përsosmërie i pranimi dhe i mikpritjes së vullnetit të Hyjit.

Shën Leoni i Madh na thotë, se askush nuk është i përjashtuar nga kjo lumturi, shkaku i gëzimit është i përbashkët për të gjithë, sepse Hyji ynë duke mos gjetur askënd të lirë nga faji, erdhi për çlirim dhe të gjithëve dhe e munda vdekjen. Ndërsa Sofonia na

dhuruar dashuri, të lejojmë që të na prek drita e Tij e vërtetë. Duhet të kuptojmë se Jehona e Betlehemit dëshiron të arrijë të gjithë ne, sepse Biri i Hyjit lindi për të gjithë dhe është shpëtimtari i të gjithëve. Një refren i lashtë liturgjik thotë kështu, o Emmanuel, mbreti dhe ligjvënësi ynë, shpresa dhe shpëtimi i popujve eja dhe na shpëto, o Zot, Hyji ynë, “*veni ad salvandum nos*”. Kjo është britma e njeriut i të gjitha kohërave, dhe ai e ndjen se vetëm nuk mund t'i kapërcejë vështirësitë dhe rreziqet. Ai ka nevojë për të vënë dorën e tij në një dorë më të madhe dhe më të fortë, një dorë e cila nga lart zgjatet drejt tij, kjo dorë është dora e Krishti, që lindi në Betlehem nga Virgjëra Mari. Ai është dora që Hyji ja ka shtrirë njerëzimit, për ta bërë që të largohet nga mëkati, «me shpresë të gjallë shpresova në Zotin dhe ai u prir drejt meje, e vështroi britmen time. Ai më nxori nga gropa e mjerimit, nga gropa plot baltë, këmbët





m'i qiti mbi shkëmb dhe m'i bëri të fortë hapat», (Ps 40, 3). Pikërisht emri Jezus do të thotë Shpëtimtar (Krh. Mt 1, 21; Lk 1, 31). Ai është dërguar nga Hyji Atë për të na shpëtuar mbi të gjitha nga e keqja e thellë, që është rrënjësuar në njeriun dhe në histori. Ajo e keqe që është ndarja nga Hyji, krenaria dhe mendjemadhësia për të vepruar vetë dhe për të bërë konkurrencë me Hyjin me dëshirën për të zëvendësuar atë. Për të vendosur se çfarë është e mirë dhe çfarë është e keqe, duke vendosur të jetë zotëria i jetës dhe i vdekjes (Krh. Zan 3, 1-7). Kjo është e keqja e madhe, mëkati i madh nga ku ne njerëzit nuk mund ta shpëtojmë vetveten nëse nuk mbështetemi në ndihmën e Hyjit duke e thirrur Atë, *“veni ad salvandum nos”*, *“eja të na shpëtosh”*. Vetë fakti i ngritjes së kësaj thirrjeje drejtë qiellit tashmë na vendos në gjendjen e duhur në të vërtetën e vetvetes. Kur Hyji e përmbushi aspiratën e popujve dhe lejoi që premtimet e profetëve të përmbusheshin, gjithçka ndodhi shumë ndryshe nga se njerëzit i kishin imagjinuar gjërat. Siç vërejmë, idetë e Hyjit janë gjithmonë të ndryshme nga mendimi i njerëzve.

Si fillim ato duken inferiore por në fakt ato i tejkalojnë distancat qiellore. Siç u theksua edhe më lart, Hyji vjen si njeri dhe e zbulon dashurinë e tij për njerëzit me një fytyrë njeriu. Nuk erdhi si një madhëri i tmerrshëm për të përmbysur botën me fuqi dhe lavdi. Erdhi i dobët dhe i pafuqishëm, i lënë pas dore dhe i braktisur. Ai vjen i fshehur dhe jo për të zbuluar gjithëfuqinë e tij, as për të bërë që mençuria e tij të shkëlqejë, nuk vjen për të triumfuar me drejtësi por për të restauruar mbretërinë e Hyjit në botë. Erdhi që të na zbulojë *“l'agape”* (dashurinë), atë dashuri që dhurohet siç e dhuron vetëm Zoti. Mençuria më e lartë e misterëve të krishterë është se Hyji është *“dashuri”* dhe dashuria na është zbuluar neve në fytyrën e një njeriu, më i miri, më altruisti, më i pasuri në dashuri midis të gjithë njerëzve, më i gatshëm për sakrificë. Misteri i Krishtlindjes është atëherë një zbulim i njerëzimit më fisnik si *“filantropia”* për të cilën flet apostulli duke na thënë: *“por, kur, u dëftua mirësia e Hyjit, Shëlbuesit tonë, dhe dashuria e tij ndaj njerëzve Ai na shëlbtoi, [...]”* (Tit 3, 4-5). A nuk është, pra, Krishtlindja festa e njeriut që sheh mirësinë e tij më fisnike të personifikuar në fëmijën e grazhdit? Të kemi kujdes të mos zvogëlojmë rëndësinë e këtij misterit sublim në tokë nga i cili na dhurohet çdo hir. Pikërisht, ky fëmijë, ky njeri, nga fytyra e të cilit shkëlqen mirësia e Hyjit, është Hyji. Biri, nga thelbi i tij i barabartë me Atin, *«fjala u bë njeri dhe erdhi që të jetojë mes nesh»* (Krh. Gjn 1, 14). Njeriu - Hyj është zbulesa më e lartë e Hyjit. Askush nuk e ka

parë kurrë Hyjin vetëm Biri i njëlindur që është në gjirin e Atit. Zoti e ka zbuluar besimin në hyjninë e këtij njeriu i cili në Natën e Shenjtë u lind nga një grua dhe na jep shpëtimin, na lejon të shohim fytyrën e dëshiruar të Atit. *«Kush më ka parë mua, ka parë edhe Atin»* (Gjn 14, 9). Krishti, Zot dhe njeri, është simboli origjinal, mister origjinal. Simboli i vërtetë është vendi ku ne shohim dhe kapim realitetin përmes imazhit. Misteri i vërtetë është vendi ku ne kapim realitetin origjinal në simbolin e shenjtë dhe në fjalë. Kjo është ajo që ndodh me Zotin Jezu Krisht. *«Sepse, Hyji që tha: Prej errësirës le të shndritë drita! Ai ndriti në zemrat tona, që të shkëlqejë njohuria e lavdisë së Hyjit në fytyrën e Krishtit»*, (2 Kor 4, 6). Megjithatë, ky shikim është ende një shikim në besim. Syri tokësor, madje edhe syri i shpirtit, sheh vetëm dobësinë dhe pafuqinë e Krishtit me ushtrinë e tij të zgjedhur, që është Kisha. Madhështia e Krishtit dhe e Kishës nuk është treguar haptas, sepse ne ende ecim në botën e mëkatit. Bota, e cila me krenari distancohet nga Hyji, nuk mund ta shohë fytyrën e pafundme dhe të pastër të Hyjit, sepse do të vdiste dhe zhdukej si dylli që shkrihet para zjarrit. Prandaj Zoti e fshehu fytyrën e tij nga mëshira dhe në të njëjtën kohë nga drejtësia. Në mbërritjen e tij të parë ai mori mishin e mëkatit, nën të cilin hyjnia u fsheh dhe vetëm në disa raste i linte shkëndijat e zjarrit të shkëlqejnë. Ai e bëri këtë me qëllim që të ofronte veten si viktimë në shlyerjen e mëkatit të botës. Ne duhet ta ndjekim në përvujtërinë e tij të vullnetshme. Ai na kërkon që të afrohem me besim, domethënë që të heqim dorë nga vetja jonë dhe të shkatërrojmë krenarinë tonë, që të hapemi para dritës hyjnore, e cila do të na japë hir. Natyra e pasur me vetëbesim duhet të vdesë. Nëse i përkushtohemi besimit, drita e Zotit tashmë është zbuluar për ne dhe ne e njohim në këtë njeri të shënuar nga mjerimi, në fëmijën e Betlehemit, në kryqëzimin e Golgotës, mbret i lavdisë, dritë hyjnore e mençurisë, fuqi e Zotit që mposht botën. Nëse festojmë Krishtlindjen, nuk duhet të ndalemi në skenën e lindjes së hirit në grazhd, por duhet të shqyrtojmë të gjithë manifestimin e Zotit. Ngjarja e Natës së Shenjtë na zbulohet në kuptimin e saj superhistorik, e përjetshme si shfaqja e Zotit në këtë botë, si një zbulim i fytyrës së tij, si një *“Epifani”*. Vetëm besimtari, mistiku di ta kuptojë këtë realitet, është ai që di të shohë Krishtlindjen ashtu siç është, fillimin dhe themelin e veprës më të lartë të Zotit, e cila transformon botën dhe e çon atë në përmbushjen e saj të përjetshme.

Duke filluar nga nata e Shenjtë Zoti është në këtë botë dhe bota është në Zotin, *“Ai është këtu”*. Bota



tani ka detyren e saj, ajo nuk humbet, por sheh rrugën që të çon te Zoti, përgjatë së cilës duhet të tregojë veten të denjë për misteret e tjera të shenjtëruara. «Zoti është në tempullin e vet të Shenjtë» (Ps 10, 4), Tempulli i Hyjit u shfaq në mish, e këta janë shpirtat besimtar, dhe bashkësia e atyre që ndiejnë praninë e Tij, që është Kisha. Në të banon Hyji falë pranisë së tij *pneumatike* (të shpirtit), që është më e lartë se çdo formë e ndihmë tokësore dhe hyjnore, e cila, duke na ngritur, na bën pjesëmarrës të jetës Hyjnore. Në kishë ai është aktiv si një forcë shpëtuese, ndërtuese, gjallëruese, ndriçuese dhe lumturuese. Ai së pari e lidhi këtë vepër me misteret e tij, të cilat ne i festojmë në liturgji. Pasi Hyji nuk dëshiron të na vijë vetëm një herë në histori dhe pastaj të largohet përsëri dhe të vazhdojë të na drejtojë vetëm nga lart. Jo, Ai na tha: «[...] Unë jam me ju gjithmonë, deri në të sosur të botës» (Mt 28, 20). Ai vepron vazhdimisht midis nesh, me anë të *pneumës*, domethënë falë forcës së Tij plotësisht të vërtetë dhe Hyjnore, e cila vjen tek ne për të na shndërruar. Ai e konfirmon këtë prani tek ne dhe e bën atë të prekshme dhe të ndjeshme përmes shenjave të jashtme, konkrete, përmes simboleve të shenjta, sakramenteve në veçanti, të cilët, jo vetëm si edukuese, por sakramentet i referohen vullnetit të tij shpëtues dhe transformues që përmbajnë praninë e Tij aktive dhe na drejtojnë në shpëtimin që vjen nga Ai. Për faktin se vetë Zoti, na është paraqitur si njeri, është simboli origjinal, kështu që tek njeriu Jezus ne shohim Atin, i cili na paraqitet me forcën dhe praninë e Tij, po ashtu ne e posedojmë Atë, me forcën dhe me veprimin i Tij shpëtues, i cili vepron në Kishë ndër shekuj, gjithmonë duke na zgjuar dhe duke na sjellur një përmbushje të një jetë të re.

Ne nuk jemi në asnjë mënyrë inferior ndaj bashkëkohësve të Jezusit. Sepse nëpërmjet mistereve të mishërimit, flijimit, dhe lartësimit të Tij bëhet për ne i pranishëm dhe i arritshëm vizioni i besimit. Nëse ne kremtojmë misteret e Krishtit si besimtarë të vërtetë, dhe mistik, po ashtu edhe bashkëpunojmë me Të, sepse bashkëpunimi është i hapur ndaj çdo të krishteri të cilët në pagëzim dhe Krezmim bëhen pjesë e gjallë e jetës “*pneumatike*” të Krishtit, në këtë mënyrë ne e gjejmë vetveten të zhytur në veprën shpëtuese të Hyjit, dhe për këtë ne tërhiqemi nga Ai dhe lejojmë të jemi të shndërruar. Ne bëhemi pjesë e misterit të Kishës në praninë e menjëhershme dhe më të gjallë të misterit origjinal, domethënë të zbulimit të Hyjit dhe të veprës shpëtuese. Përmes këtij misteri ne jemi të shëlbuar nga vepra shpëtuese e Hyjit, e cila filloi në dritën e qartë të historisë dhe u përmbush në dritën e

përjetësisë, pikërisht në këtë dritë të pafundme Hyjnore. Lindja e fëmijës së Betlehemit na bën të gjendemi përpara Fjalës së Hyjit dhe të përjetësisë së Atit, të qetësisë së përjetshme të Trinitë në përkohshmërinë e krijimit tonë, kështu që gjithçka të kthehet në Hyjn. Vdekja e Krishtit në kryq nuk është më vdekja e një njeriu të ekzekutuar, por sakrifica e tij totale është shpengimi i njerëzimit, që i jep përsosmëri Kishës duke e bashkuar atë me Atin. Kështu, përmes misterit, ne vendosemi në plotësinë e plotë të realitetit të Shpëtimtarit, në forcën e mishërimit, në gjakun shëlbues të flijimit dhe në lavdinë shndërruese të ringjalljes së Tij. Ne jemi përfshirë kështu në jetën e Krishtit, me pjesëmarrjen në fuqinë e Tij, në mençurinë e Tij, në shpirtin e Tij, në këtë mënyrë ne bëhemi pjesë e këtij trupi që jetojmë jetën e Tij, në këtë mënyrë hyjnizohemi dhe ngritemi si njerëz të vërtetë të Hyjit. Ne marrim forcën për të rezistuar në jetën e përkohshme tokësore, me dhimbjet dhe mjerimet, me përndjekjen e së keqes dhe triumfin e së mirës, për të duruar dhimbjet e sëmundjes dhe vdekjes, pasi me qenien tonë tashmë jemi në një natyrë krejt tjetër në Krishtin. Nëse e festojmë Natën e Shenjtë me Kishën nënë atëherë me të vërtetë jemi duke festuar Krishtlindjen, kjo është nata e Shenjtë, në të cilën toka zhduket dhe jeta e përjetshme hapet me ne, e cila nuk do të mbarojë kurrë.

Maria, nëna e Virgjër, dhe nëna e Kishës së Shenjtë, ajo na jep jetën e vërtetë, Jezusi është për ne fëmija, falë thelbit të së cilit ne të gjithë gjenerohemi nga Hyji dhe arrijmë pjekurinë e plotë të Krishtit.

Si Maria e cila e ka gjeneruar Jezusin, na mësoftë edhe neve që të bëjmë një strehë për të. Ajo e cila e vendosi me dashuri të madhe në grazhd, e vendostë me kujdes amënor edhe në zemrat tona, që të prekemi nga hiri i Tij që na dhuron paqen dhe gëzimin e vërtetë.





Don Nosh GJOLAJ

## CIKLI I NATËS DHE AI I DITËS DUHET TË RESPEKTOHE (Pjesa e tretë)

### Ritmi i jetës

Nuk duhet harruar faktin real, derisa meshkujt jetojnë në Mars kurse femrat në planetin e Venera (Afërdita) gjërat janë ideale apo të idealizuar (shpirti im, zemra ime, pa tu nuk më kapë gjumi i natës...) Po sa kalon muaji i mjaltit dhe fillon jeta reale në planetin Toka në bashkësinë martesore, fillojnë të dalin në pah edhe ato gjëra që përpara as nuk i kishin menduar fare, sepse nuk kanë jetuar së bashku. Mes tjerëve është edhe ritmi i jetës, e cila shprehet në llojllojshmërinë: stili i jetës, shprehinë e llojllojshme, temperamentit apo karakterit etj.

Të mbesim në lëmin e ritmit të jetës. Si fjala bie, ajo është e lodhur që nga orët e natës por ngritët herët në mëngjes. Ai mund të vigjilojnë deri orët e thella të natës përderisa në mëngjes nuk mund të ngritët. Kjo sjellje ndikon për të krijuar shprehinë edhe në botën intime në fushën e dashurisë që mund ta luajnë rolin negativ duke krijuar mos kënaqësinë, e mos të themi shpërpushje në harmonizimin në sferën dashurisë (seksuale). Për këtë është me rëndësi ritmi i jetës që kërkon jo vetëm korrigjim por edhe harmonizimin e përbashkët.

Segmenti i dytë për të qenë martesa e jeta e saj pak a shumë e suksesshme luan një rol të rëndësishëm qëndrimin apo pikëpamjet ndaj jetës shpirtërore, muzikës, udhëtimit, sportit, leximit, aktivitete shoqërore politike e sociale, jeta kishtare etj.. Gjatë jetës së përbashkët partnerët zbulojnë edhe dallimet ndoshta edhe të mëdha që përpara as nuk i kanë vërejtur as menduar, së pakut në mënyrë të vetëdijshme, tani është koha e fundit për t'i shqyrtuar e për t'i harmonizuar.

Për këtë arsye është e nevojshëm harmonizimi i orarit të ditës, javës, muajit, për ta evituar konfliktet, si për shembull: “Në këtë shtëpi nuk ka rënd, dhe nuk di kush pi e kush paguan, por secili sjellët sipas qejfit!” Ashtu fillojnë fajësimet, akuzimet, fjalosjet, mosmarrëveshjet deri te pakënaqësia që nuk kontribuon për t'u korrigjuar por në të kundërtën çiftin e zbrazë dhe ia thitha atë energjinë deri në pikën e fundit. Mos harmonizimi i ritmit të jetës menjëherë e ri aktivon stereotipin apo paragjykimet e të kaluarës, si fjala vjen, nuk e sulmon partnerin direkt por familjen e tij: “Ju nuk dini çka është pushimi veror në plazhin e Ulqinit (Durimit) ?” – “Po qe se dëshiroj të flas me babin tënd duhet më përpara t'i lexoj gazetën e ditës e ta

njoh politiken ditore!” Që nuk janë asgjë tjetër përveç goditjet njëri-tjetrit, dhe atmosfera e tillë pengon bisedën e përbashkët, (dialogun) . Është shumë e rëndësishëm vetëdijesimi për ta harmonizuar ritmin e jetës dhe të shkunden nga shprehinë e trashëguara. Kuptohet vetvetiu se çdo njeri i bartë ato fije apo hijen e papashme të trashëguar nga familja, dhe ato shfaqen në përmes kaluarës, që ia m veshim më vonë mbeta e prindërve apo dikujt tjetër.

Po qe se të dy partnerët e kanë të qartë situatën aktuale dhe vetëdijesohen, atëherë lehtë mund të bisedojnë për problemet e mospërputhja e ritmit të jetës e për ta harmonizuar. Por përpara duhet të verifikohen pohime apo supozimet e bëra. Çdo individ e ka fushë veprimin e vet. Kundërthëniet nuk janë aq të mëdha që nuk mund të kapërcehen. Por së bashku kërkohet emërtimi i përbashkët. Çdo palë duhet të jetë e gatshme për t'u korrigjuar e për t'u ndërruar sa është e mundshme për t'u përshtatë mjedisit të ri në rastin tonë martesor. Çdo palë ta shohin mundësin për ta gjetur kompromisin. Po ashtu çdo palë duhet ta gjejnë shikimin apo mundësin e tretë: të respektohet e t'i njihet liria njëri-tjetrit, në të cilën nuk mund të gjendet emërtimi i përbashkët. Partnerët duhet të vetëdijesohen e të binden se gjatë dialogut mund të rrëshqasin në tri gabime:

1. Dogmatizmi, që nuk është asgjë tjetër përveç direktivat e jetës, që dikush i absolutizon, si të sigurtat dhe të vetmet, e nuk mundohet t'i paraqesin në mënyrë të arsyeshme. Si për shembull: “Në mëngjes duhet herët për t'u zgjuar, që të kemi diçka prej ditës.” Në të vërtetë individ i tillë i takon njerëzve e tillë, të cilët nuk janë të ndershëm por me tjera fjalë paraqesin vetveten në pasqyrë, dhe nuk janë asgjë tjetër përveç kamuflimi i arsyes së mendjes së shëndosh prej pakuptimit apo prej frustrimeve të kaluarës.

2. Qëndrimi, se dikush mund të mendoj se e ka gjithëherë të drejtë. Në raste e shumta nuk është fjala që të kesh apo jo të drejtë, por thjeshtë është një kategori e gabuar e mos të themi qëndrimi i dështuar. Sepse nuk ka të drejtë as ai që ngritët herët në mëngjes, as ai që flenë shumë me gjumin e zgjatur. Por ata thjeshtë janë dy individ të ndryshe të cilët i kanë qëndrimet e skajshme. Thelbi është vetëm ta pranosh dallimin e ta harmonizosh së bashku.





3. Mendimet dominuese, te dallimet e menduarit apo pikëpamjeve njëri nga çifti martesor i cili gjithherë duhet të dominojë. Një qëndrim i tillë është mjaft i rrezikshëm, se e përjashton mundësin e korrigjimit dhe i tejkalon kufijtë tolerancës. Partneri në këtë rast, në vend t'ia lejojnë lirin e mendimit si dhe përcaktimit të tjetrit, ia rrëmben për ta krijuar qëllimin e përbashkët bile edhe për hir të nënshtrimit. Që do të thotë vdekja e partnerit.

### **Shumë mirë e paraqet shembulli më poshtë se kush është fajtor ?**

Në një kodrine jetonin së bashku Gjoni dhe Roza, ata e kishin një shtëpi të bukur dhe të mobiluar mirë. Një prej netëve papritmas shtëpia filloi të digjet nga zjarri. Çifti i ri Gjoni dhe Roza, banorët e kësaj shtëpia shpëtojnë nga flaka e zjarrit që e kishte kapluar shtëpinë. Ata mëmësi shpëtuan jetën, dhe në oborrin e shtëpisë fillojnë të grinden në mesin e vetes, në vend ta shuajnë zjarrin, se kush është fajtor dhe shkaktar i zjarrit.

Gjoni i hidhëruam i drejtohet bashkëshortes: "Një qind herë të kam thënë, mos shko të flesh para se ta fiksh zjarrin në kuzhinë. Shiko, se çka është bërë, e kemi humbur shtëpinë. A je tani e kënaqur?" Roza i përgjigjet: "Nuk është faji im! Ti je fajtor. Të kam thënë një mijë herë, që mos e pi duhanin në shtrat. Por si të thuash ty është baras si ti them murit. Askurrë nuk e ke kuptua. A nuk e sheh si zjarri ka filluar nga dhoma e gjumit, dhe jo nga

kuzhina? Qartas është se kush është fajtor!" "Mbylle atë gojë, dhe hesht" bërtet Gjoni "Vetëm ti donë të më përulësh dhe të më tallesh me mua. Unë pohoj : ky është faji yt. Vetëm faji yt dhe askujt tjetër, pikë!"

Ndërsa ata shama-tohen se i kujt është faji, zjarri u hap dhe e dogji shtëpinë në tërësi me gjitha mobilet dhe vlerat që i kishte shtëpia. Përpara se Gjoni dhe Roza ta zbulojnë se kush është fajtor, shtëpia e dashur u bë një grumbull hirit.

Kompromisi për t'i harmonizuar konfliktin kërkon nga dy partnerët edhe diçka për të lëshuar

pe që nuk është e këndshme. Në këtë rast duhet të ketë kujdes që barra të jetë sipas mundësisë e ndamë në mënyrë të barabartë sipas talenti apo dhuntive që partnerët posedojnë, sepse po qese hedhet barra e rëndë atij tjetrit, aty krijohet agresiviteti që mund të na çojë deri te shpërthimi ndaj partnerit duke krijuar një gjende kaotike.

Nganjëherë partnerët mund ta shkaktojnë konfliktet e përditshme që është diçka normale e kuptueshme për çiftin normal dhe të shëndoshë. Por kur i kalojnë kufijtë, e cila mund ta godasin e ta grushtojnë njëri tjetrin me goditje të rënda e arrogante që nuk mund të barten. Në rastet e tilla nuk bëhen të heshtet emocioni e lëndimi të shkaktuar nga tjetri, por duhet të shtrohet e të analizohet së bashku. Krishterët të cilët janë të orientuar e të frymëzuar nga Ungjilli, ata do ta shpien në veprim pikëpamjet e veta ungjillore. Në rendin e parë nuk është lëndimi im personal, por pyetja: Pse ishe i tillë? Gatishmëri për ta falë, që nuk është asgjë tjetër përveç të jesh pran partnerit i mirë edhe pse i lënduar dhe i gatshëm për mos ta rrezikuar bashkësinë martesore. Të keqen do ta kthesh me të mirën!

Unaza e martesës, shenjë e dashurisë dhe besnikërisë. Dashuria dhe besnikëria mund të bien në stuhi. Mund të vijnë ditët kur s'ec më, kur asgjë nuk shkon më. Nga marrëzia dhe dështimi është krijuar një plasaritje, përmes të cilës, në zemrën dhe shtëpinë tënde, depërton terri. Atëherë ekziston vetëm një rrugëdalje, vetëm një dalje në dritë: falja!



Dom Lush GJERGJI

## FAMILJA DHE EDUKIMI I ADOLESHENTËVE

### *Psikologjia dhe feja*

Çdo prindër dëshiron edukimin e mirë të fëmijëve, kështu që ata më vonë të jenë të mirë, të sigurt dhe të lumtur në jetë. Mirëpo kjo fatkeqësisht nuk ndodh. Përse?

Ka shumë shkaqe dhe arsye. Unë do t'i numëroj vetëm disa:

Së pari plotësimi i të gjitha dëshirave të fëmijëve, aq sa fëmija sot është bërë pothuaj “diktator” për familje, kërkon dhe kushtëzon çdo gjë dhe menjëherë, dhe prindërit duken të paafte, disi lëshojnë pe, dorëzohen para këtyre kërkesave, gabojnë rëndë duke menduar dhe thenë: s'dua që fëmija im të vuaj si unë.

Mungesa e vlerave dhe virteteve personale, familjare dhe shoqërore, si dhe mungesa e madhe e modeleve kulturore dhe shpirtërore. Adolehentët s'duan dhe s'mund të jenë më si prindërit e tyre, sidomos për familje në rrethe të huaja, në diasporë, si dhe për prindër të varfër dhe të pashkolluar, të trajtuar si “primitive” dhe të prapambetur. Prindërit s'janë gati aspak të përgatitur për rrethe të reja, për edukim të ri, të hapur, ku lypset kërkuar të mirën e përbashkët nëpërmjet bisedimeve, dialogut dhe komunikimit, por më tepër insistojnë në rregullore, në disiplinë, në autoritet edhe të “grushtit” të fortë.

Disorientimi edukativ, sepse tashmë askush nuk e di saktësisht dhe përfundimisht çka domethënë të jesh prindër, edukator, pasi ka ndryshuar botëkuptimi i jetës dhe i punës, tradita, kultura, ekonomia, politika, shkenca, arti, gati çdo gjë. Globalizimi e ka përfshirë mbarë botën, por më tepër në dukuri negative, sidomos me anën e mjeteve pamoro-dëgjimore, duke ia imponuar njerëzimit materializmin, hedonizmin, indiferentizmin dhe ateizmin praktik, me pasojë tejet të rënda për jetën kulturore dhe shpirtërore.

### **1. Krijimi i personalitetit dhe identitetit**

Pa njeri s'ka as familje as shoqëri. Edukimi familjar është baza e çdo edukimi të mëvonshëm, sepse në familje formohet personaliteti bazor dhe identiteti personal. Çka domethënë personaliteti bazor? Pranimi i prindërve, vëllezërve, motrave, rrethit familjar, si dhe pranimi i vetvetes në prizmën pozitive, me procesin e identifikimit me prindër, me procesin e socializimit – hapjes dhe bashkëpunimit, bashkëjetesës me të tjerët. Pa këto dy procese bazore s'ka as fëmijëri as rini.

Shprehja edukimi, edukata vjen nga latinishtja dhe ka dy veshtrime: educare – të ushqesh, apo e-ducere = të nxjerrësh jashtë, të udhëheqësh, të drejtosh kah. Prandaj ushqimi duhet të jetë i trefishtë: trupor, mendor (psikik) dhe shpirtëror.

Të nxjerrësh jashtë, të drejtosh dhe të udhëheqësh dmth. se adolehenti është qenie njerëzore, person, qysh nga ngjizja, lindja, prandaj duhet zbuluar në të

mundësitë, aftësitë për ta nxjerrë nga bota e vogël, nga barku i nënës dhe i familjes, për t'u bërë vërtet njeri i matur dhe i pjekur, qytetar i botës (mondialiteti).

Edukimi duhet të zbulojë aftësitë e fëmijës, adolehentit, ato duhet përkrahur dhe zhvilluar, duke nderuar natyrën, karakterin, talentet, moshën, gjininë... për ta ndihmuar dhe drejtuar kah vlerat dhe virtetet.

### ***Familja duhet të edukojë sidomos:***

Me pranimin e gjithanshëm të fëmijës, ashtu si është, e jo ashtu si mendojmë dhe dëshirojmë ne, sepse ashtu e ngarkojmë apo projektojmë sipas dëshirave dhe nevojave tona. Prindërit të cilët nuk janë të kënaqur me vetveten, me palën martesore, mundohen nëpërmjet fëmijëve ta realizojnë veten me pretendime: biri apo bija ime do të bëhet..., do të jetë..., do të fitojë... Kjo mënyrë e ngarkon dhe rrënon fëmijën, sepse ia cakton një rol, një detyrë, një mision të pamundshëm, t'iu përgjigjet nevojave dhe kërkesave, ëndërimeve të prindërve. Fëmija gjendet gjithnjë në konflikt me vetveten, me prindër, me shoqëri, dhe së fundi rrezikon identitetin: kush jam unë, çka dua unë, dhe si dua unë të realizohem.

Çdo njeri së pari duhet të jetë vetvetja, pastaj mund të jetë edhe me të tjerët dhe për të tjerët.

T'i edukojmë fëmijët, adolehentët për jetë dmth. t'i aftësojmë për ballafaqime me të tjerët, jo për të sunduar mbi të tjerët, tendencat diktatoriale, apo për t'iu nënshtruar të tjerëve, tendencat për servilizëm. Edukimi i rreptë dhe me ndalesa, ndoshta edhe me ndeshkime, fëmijën e bën të pasigurt, prandaj e shtyn që të mbështetet në të tjerët, pa formimin e unit, ego-s, kështu që gjithnjë do të jetë i mvarur prej të tjerëve.

Çdo rregull, ligj, normë pa motivim, mirëkuptim dhe dashuri, e edukon fëmijën për dyfityrësi, sa për sy e faqe dëgjon dhe vepron sipas kërkesës së prindërve, por pa bindje, përcaktim, vetëm formalisht. Ose skajimi tjetër mund të jetë anarkist – t'i urrejë dhe kundërshtojë të gjitha rregullat, ligejt në fëmijëri dhe në rini, sepse si fëmijë ka pësuar jetën, s'ka pasur fëmijëri dhe rini të qetë dhe të bukur.

Familjet e rrepta dhe represive edukojnë hajna, rrenca, mashtrues, kriminelë, ata të cilët s'kanë pasur përvojë dashurie, përgjegjësie, por lirinë e kërkojnë në anarki dhe në shkelje të noramave familjare, shkollë, shoqërore dhe fetare.

### **2. Të jesh prindër sot**

Shumë prindër nuk dinë më çka domethënë të jesh babë apo nënë, pra, s'dinë si duhet të jetojnë dhe të veprojnë mes tyre, edhe më pak me fëmijë. Fëmijët nëse shumen si fryt i ndërsjellët i dashurisë, ndihmojnë shumë edhe çiftin martesore, kërkimin e bashkëshortisë, sepse:

- zgjerohet dhe thellohet komunikimi ndërpersonal



në martesë dhe në familje;

- shtohet dhe begatohet jeta afektive dhe emotive, dashuria;

- rritet pjesëmarrja e të gjithëve në jetën familjare. Lindja dhe edukimi i fëmijëve, adoleshentëve, tregon aftësinë e prindërve për jetën martesore. Vetëm pas lindjes së fëmijës hetohen më qartas qëllimet e martesës, që mund të jenë të llojllojshme:

- për t'i ikur vetmisë, familjes së preardhjes, e cila është e rrebtë dhe s'lejon asgjë;

- për të pasur së paku dikë (fëmijën) dhe diçka (familjen) për vetë;

- për të qenë i rëndësishëm para të tjerëve;

- për të siguruar pasardhësin, sidomos tek ne shqiptarët, me djalin...;

- për të dalur prej rrethit të ngushtë, tek shqiptarët martesë është shndërruar edhe në bisnis, për të shkuar në botë, jashtë Kosovës, me fejesa dhe martesë për vizë...



Nëse nuk është në rregull marrëdhënia martesore, s'do të jetë në rregull as ajo me fëmijë, me të tjerët, sepse pakënaqësia, mosrealizimi, frustrimi, hurxhi, konfliktet, krijojnë mosdurim, agresivitet, shpërthime në grindje dhe përçarje të vazhdueshme.

Pas lindjes së fëmijës burri mund ta ndijë veten i përjashtuar dhe i harruar, sepse s'është më në qendër të vëmendjes, pra, mund të lind edhe xhelosia, sipas fjalës së urtë shqiptare: "Fisnike, tash je përtej djepit dhe detit!", që dmth. se mes nesh është djepi, fëmija, që na largon si deti, si dy bota.

E vërteta themelore është kjo: fëmijët nuk janë për prindër, por prindërit për fëmijë! Kjo vlen në veçanti për botën femrore shqiptare, sepse femrat tona mundohen zbrazëtitë e tyre afektive dhe emotive, jetësore t'i mbulojnë dhe projektojnë në fëmijët e tyre me motivime si: së paku jam nënë, kam fëmijë, ata le të jenë të lumtur, sepse edhe ashtu s'kam asgjë nga jeta përpos vuajtjes dhe fëmijëve...

Prindërit që s'janë të bashkuar dhe koherentë, u japin fëmijëve porosi të gabuara, sepse njëri thotë po, tjetri thotë jo, duke shkaktuar kështu pasiguri, nevrozë, frikë, shqetësim, dyshim dhe thyrje psikike.

Pjekuria personale dhe martesore, familjare është parakusht për edukimin e fëmijëve, sepse nuk edukojmë me fjalë, me porosi, por më tepër me shembëll dhe me jetë. Në familje të papjekur apo në konflikt, fëmijët shpesh shndërrohen në "objekt", lodër apo vegël për ta luftuar çiftin martesor, duke rënë nën kështu veten, por edhe fëmijën dhe fëmijërinë e tyre. Pytja: kë e do më shumë? A je me mua apo me... janë "lojëra" dhe ngarkesa shkatërruese, sepse fëmija kështu disorientohet, habitet, s'di më më kë duhet të jetë, herë anon kah babai herë kah nëna.

Familja, edhe pse ka pësuar ndryshime të mëdhaja dhe rrënjësore, prapë mbetet rrethi i parë natyror i çdo edukimi, përgjegjësie për fëmijë dhe për rini. Mu për

këtë familja s'mund të jetë indiferente, neutrale, t'i edukojë fëmijët vetëm për përshtatje ndaj jetës dhe punës, por duhet t'ua jep përvojë kujdesi, mirësie, butësie dhe dashurie, sepse është bartëse dhe edukuese për jetë dhe për vlera.

Edukimi është kryesisht aftësimi i fëmijës për zgjedhjen e vlerave dhe të virtyteve, si ndërmjetësim mes familjes, shkollës, shoqërisë.

Si mund ta bëjnë prindërit këtë?

Me dialog të hapur dhe të sinqertë në familje, në shkollë, kudo... me të gjithë ata që merren me

edukimin e fëmijëve. Tek ne qysh moti është rrënuar hallka apo zinxhiri familja- shkolla - feja - shoqëria, dhe secili vepron si di dhe si do, por pa ndonjë harmonizim dhe bashkëpunim.

Me edukim në vazhdimësi (permanent) të prindërve, si proces jetësor për vete dhe për të tjerët. Tek ne pak i jipet rëndësi edukimit dhe formimit permanent, si në anën profesionale, ashtu edhe familjare, sepse mendojmë se dimë dhe mundemi edhe pa këtë.

Me angazhim të vazhdueshëm për t'i njohur nevojat, dëshirat, problemet e brezit të ri, dhe për të qenë në shërbim të tyre.

Sot fëmijët kanë shumë vështirësi dhe halle të ndryshme, si p. sh. frika, mosbesimi, mbyllja në vetë, vetmia, shqetësimi para luftës, terrorizmit, varfërisë, papunësisë, ndarjes së prindërve, garimi, rivalitetet, mosdurim...





## RRJEDHJA E BESIMIT PËRGJATË EVOLUIMIT NJERËZOR

Përgjatë 20 viteve të fundit, morëm pjesë në një shtim të pyetjeve në lidhje me sektorin e bioshkencave dhe të neuroshkencave. Veçanërisht interesante paraqitet pyetja se kur dhe si ka lindur “aftësia e të besuarit” gjatë evoluimit të njerëzimit. Në fakt, kështu ajo duhet të jetë, e pafundme nga pikëpamja biologjike. Libri “The Emergence of Religion in Human Evolution”, i botuar në dhjetor të 2019, përpiqet që të japë përgjigjen e një pyetjeje të tillë. Ky studim lind nga bashkëpunimi mes Margaret Boone Rappaport, biologe dhe antropologe- kulturore amerikane, e specializuar në evoluimin konjektiv njerëzorë dhe Christopher J. Corally, astronom britanik dhe prift jezuit, pjesëtar i grupit të kërkimit “Spekulimi Vatikan, i Castel Gandolfo”, afër Romës. Të dy shkencëtarët punojnë në Tucson, në Arizonë (USA).

### Kapaciteti i besimit të Homo sapiensit

Dy kapitujt e parë të librit na përfshijnë në këtë kërkim të ri dhe na tregojnë ndryshimet e ndryshme pragmatike, mbi të gjitha për sa i takon evoluimit të homonidëve, funksionimit të mendjes. Është e dukshme që mes linjave të ndryshme gjenetike të homonidëve, studimi tenton, që të përqendrohet mbi vetë specien tonë, Homo sapiens, kështu siç është evoluon dhe do të vazhdojë të evoluojë.

Sipas dy autorëve është e mundur që të tregojmë se aftësia e të besuarit e Homo sapiensit, është një karakteristikë neurokonjektive, tepër e zhvilluar. Kjo duket se bazohet mbi evoluimin, që është një i vetëm, tepër i rëndësishëm, e kështu gjenetik, e duket sikur gjendet vetëm në Homo sapiensin. Në fakt, janë gjithnjë e më shumë tregues shkencorë që janë parashikuar. Diferenca mes Homo erectus dhe Homo sapiensit, i çon autorët që të pyesin se cila është lidhja mes tyre, duke qenë se shumë nga ajo që mund të zbulojmë fillimisht ka treguar se është thelbësore, pasi i dyti ka mundur të shprehë për herë të parë një “aftësi për të besuar”.

Homo erectus e ka origjinën rreth 1.9 milion vjet më parë, në Afrikë, me shumë mundësi të një specie njerëzore më e vjetër, Homo habilis. Me Homo erectus, të qenit njerëzor ka lënë përgjithnjë jetën e tij mbi pemë dhe është transferuar në savanat, në grupe rreth 100 individësh. Me argumentime të vlefshme autorët mbështesin se pikërisht te këto grupe gjahtarësh, kujtojmë se Homo erectus e kishte origjinën mishngrënëse, janë bërë evoluime

të rëndësishme: lindja e një gjuhe fillestare, aftësia për të zotëruar dhe përdorur zjarrin, rreth 1.5/1 milion vite më parë, kapaciteti për të prodhuar instrumente. Mes këtyre mundësive të reja, dallohet dhe ajo morale. Iu dha rëndësia kësaj të fundit, në zhvillimin e një kapaciteti për të besuar, dy shkencëtarët ndalen gjatë për ta përshkruar dhe analizuar.

Që të jetë një aftësi morale duhet që të kemi 2 lloj kapacitetesh neurokonjektive, që ishin të pranishme në speciet Homo erectus. Në vend të parë, arkeologjia na ka bërë që të njohim nivelin e sofistikuar të prodhimit të instrumenteve të Homo erectusit. Kjo tregon një aspekt të menduarit, që bën të mundur si referimin nga e kaluara si projektimin projektues në kohën e ardhme. Në vend të dytë paleoneurologjia tregon prezencën e një kapaciteti për t'u pyetur dhe që të kenë mundësi për t'i dhënë shpjegime fenomeneve dhe eventeve. Këto dy mundësi konjektive, së bashku me një gjuhë fillestare, që e bëri të mundur analogjia laringale e Homo erectus-, u bënë të mundura, pasi është një lloj i cili mund të veprojë moralisht.

Megjithatë, nuk kemi një njohje të drejtë të trashëgimisë gjenetike të Homo erectus (nuk e zotërojmë gjenomën), që mund të fillojë prova vendimtare në mbështetje të këtyre hipotezave të mirëformuara. Për momentin, pra, kjo do të rrijë një hipotezë, deri kur zbulime të reja do na ndihmojnë të kuptojmë më mirë të tilla çështje.

### Kapacitet moral dhe kapacitet fetar

Në libër, qartësohet që kapaciteti moral, diferencohet nga kapaciteti religjioz, të dyja këto mundësi futen në karakteristikat neurokonjektive. Po aftësia për të besuar kërkon zhvillime të brendshme, ndër të cilat praninë e genit FOXP2, që e gjejmë në Homo sapiensin, përgjegjëse për formën gjuhësore, që na karakterizon. Një gjen i tillë nuk është i pranishëm në Homo neanderthalensis, që është një disident i ardhur direkt nga Homo erectus. Ai ka lindur rreth 800 000 vjet më parë, shumë më përpara Homo sapiensit, ky i fundit i zbuluar vetëm 300 000 apo 400 000 vite më parë.

Një tjetër e re e Homo sapiensit është aktivizimi gjenetik i zonës HAR mbi kromozomin 20, i cili u bë përgjegjës i kuptimit të rritjes së volumit të mendjes dhe të rrumbullakësisë së kafkës, në specien tonë. Bëhet fjalë për një kod gjenetik, i cili



ka qëndruar i pandryshueshëm në linjën tonë të primatëve prej 60 milion vjetësh apo më shumë dhe që tregon vetëm në specien tonë një ndryshim, që konsiston në një aktivitet gjenetik, dukshëm më të madhe.

Sipas një pikëvështrimi të tillë, ka akoma shumë punë kërkimore për t'u bërë, por nuk duhet që të presim që të gjendet diçka e ngjashme me “specien e Zotit”. Aftësia për të besuar mund të jetë një karakteristikë neurikonjektive e bazuar në gjenomën, e cila është rezultati i shumës së karakteristikave të ndryshme neurokonjektive, shumë të hershme. Me homo sapiensin, jemi përballë traktateve më të fundit, që gjejnë zbatim në një mjedis të ri dhe që krijojnë mundësi të reja. Por, mbi këtë pikë do të flasim pak më vonë, në mënyrë të detajuar.

### **Lindja e kulturës**

Çfarë mund të themi rreth zhvillimit të kulturës? Ajo a ka një bazë biologjike? Të dy autorët i japin një përgjigje pozitive kësaj pyetjeje. Me “kulturë” kuptojmë tërësinë e sjelljeve dhe të shprehive, që në brendësi të species, mund të ndryshojnë nga njëri grup te tjetri, deri në pikën kur një individ, nëse do të futej në një grup fqinjë, nuk do të mund të jetonte dhe të vepronte pa një periudhë të nevojshme përshtatjeje apo “shoku” kulturor. Në këtë kuptim, origjina e kulturës llogaritet nga dy shkencëtarët, shumë më përpara, 8 milion vite më parë. Në fakt, duket se edhe shimpanzetë, në një formë më të dobët dhe lloje të ndryshme homicidesh, në një mënyrë më të theksuar, zotëronin atë që mund ta konsideronim “kulturë”. Kështu, miliona vite më parë, pati një sulm të përbashkët me karakteristika cerebrale, që e bënë të mundur rrjedhjen e kapacitetit kulturorë.

Dy studiuesit janë të vetëdijshëm që çështja e krijimit biologjik e fenomenit besimtarë, apo aftësisë për të besuar, mund të befasojë shumë teologë apo çdo njeri, që merret me besimin, çdo besim, i rëndësishëm për atë vetë apo për komunitetin, të cilit i përket, por për një biolog kjo nuk i duket e çuditshme. Për të, në fakt, çdo veprimtari e qenies njerëzore, edhe mendimi i tij edhe veprimi i tij, nuk është vetëm një shprehje kulturore por edhe një karakteristikë biologjike. Diçka në mendjen tonë na lejon që të sillemi në mënyrë fetare, të mendojmë sipas besimit, për të pasur një eksperiencë besimtare, për të njohur tradita të tjera si shprehje besimtare, edhe pse janë shumë të ndryshme nga ajo e jona. E gjitha kjo ndodh edhe nëse vëzhguesi nuk është besimtarë. Megjithatë, dy autorët vënë në dukje se jo të gjithë individët e llojit tonë e zotërojnë aftësinë e të

besuarit, ashtu siç sot ka njerëz që nuk e kanë as aftësinë morale.

Pas këtij prezantimi libri, mbase mund t'i lindë ndokujt dëshira për ta lexuar. Por duhet ta paralajmërojmë që teksti nuk është i thjeshtë për t'u kuptuar edhe pse është i mirëstrukturuar dhe ka një zhvillim gradual, ka bibliografi të pasur dhe i referohet shumë teksteve të tjera alternative. Vështirësia është se nuk bëhet fjalë për një libër me përbërje shkencore. Të kuptuarit e tij, kërkon që ne të kemi njohuri të mira për biologjinë, mundësisht të integruara me njohuritë antropologjike dhe filozofike.

Është i dëshirueshëm publikimi i një libri më të hapur mbi këtë argument, kështu për t'i bërë këto zbulime dhe opinionet e dy autorëve të pranueshme për një popullsi më të gjerë. Kjo mbase do të ndodhë në të ardhmen, por tani duhet të kënaqemi me argumentet që 2 studiuesit na propozojnë. Bëhet fjalë për t'i bashkuar dhe për t'i përpunuar zbulimet e këtyre 9 disiplinave shkencore: antropologjia kulturore, arkeologjia e gurëve dhe e kockave, arkeologjia konjektive, shkenca konjektive, gjenetika, gjenetika e popullsisë, shkenca e gjenit njerëzorë, paleoneurologjia dhe neuroshkenca. Shumë nga këto shkenca janë akoma në një fazë zhvillimore dhe vazhdimisht bëhen zbulime të reja.

Por, duke u bazuar në të dhënat e marra, autorët formulojnë këtë lajm: hipoteza qendrore e këtij libri afirmon që mendja dhe kapacitetet neurologjike që kanë bërë të mundur një ekonomi tregu e social-konjektive fillimisht për Homo sapiensat, vazhdojnë të jenë të njëjtët organe shtetërore dhe të njëjtat mundësi që kanë premtuar bashkimin e mendjes besimtare dhe të veprimit besimtarë. Provat arkeologjike, më antike në këtë kuptim, mund të datojnë rreth 190 000 viteve më parë, dhe padyshim në linjën e evoluimit të Homo sapiensit. (pra tonën).

### **Eksperiencia e besimit dhe atësia gjenetike**

Dy autorët janë të vetëdijshëm që libri i tyre është i pari i një serie të studimeve të mëvonshme në këtë kamp kërkimi. Duhet të jetë mirë që teologjikët e specializuar të përkushtoheshin e të vazhdonin këtë kërkim dhe për të zhvilluar rezultatet. Mbase dikush është duke e bërë. Nga ana jonë, jemi të bindur që ky grup kërkimi mund të influencojë koncesionin tonë të njeriut dhe mund të na çojë në një vizion të ri të fenomenit të besimtarit, në botën e krishterë dhe jo vetëm, me një impakt të vetëndërgjegjësimit të besimit të njeriut, të antropologjisë edhe të teologjisë.

Aftësia për të besuar nuk mësohet apo blihet, por



është një trakt konjektiv i ndryshueshëm nga njeriu te njeriu.

Dy shkencëtarët janë të vetëdijshëm për këtë sfidë, megjithatë i kujtojnë lexuesit që libri nuk krijon linja udhëzuese për jetën e tyre shpirtërore, po kërkon të sigurohet dhe t'i ndihmojë për të kuptuar që kërkimi i një eksperience prej një besimtari është e arsyeshme dhe e ka origjinën në evolucionin e species sonë, dhe që mendimi lexues nuk është i çuditshëm, ose një shenjë dobësie, ose një simptomë të një bote e prapambetur. Pyetjes: Përse besimi është kaq i rëndësishëm për kaq shumë persona në të gjithë botën? Ato do t'i përgjigjen: “Sepse është trashëgimia jonë biologjike”.

Pavarësisht diferencave kulturore, eksperiencia e besimit është universale. Për këtë arsye do të mund të njohin sjelljen e një shamani në Amazonë, celebrimin eukaristik të një prifti në Romë, apo meditimin e gjatë të një murgu budist në Tibet. Aftësia e të mësuarit nuk mësohet apo blihet përgjatë kalimit nga fëmijëria në të rritur, por është një trakt konjektiv që varion nga individ i individ dhe është në dorë të njeriut që ta shprehë apo jo. Përpiqemi tani të marrim në konsideratë se cili mund të jetë kontributi i vërtetë neuroshkencës. Duhet që specia jonë të jetë në gjendje të influencojë në mënyrë interaktive mendjen

njerëzore, neuroplastike, për të modifikuar kapacitete të tilla, duke fuqizuar apo ulur ndikimin në vendimet tona. Këto vendime na bëjnë të mendojmë sesa i rremë është një vizion shkencor, që e prezanton njeriun si një qenie krejtësisht të vendosur në të gjitha aspektet. Karakteristika e gjenetikës sonë është ajo për të krijuar mundësi të papritura, për të tejkaluar limitet e tyre. Dhe nga ana tjetër është mënyra jonë e të menduarit, që e bën të mundur ndikimin në gjenomën tonë.

### **Rrjedha gjenetike dhe aftësia e të besuarit**

Duke lexuar lirin befasohemi nga zbulimet e bëra gjatë këtyre 10 viteve të fundit. Është mbresëlënëse që të kuptojmë unicitetin e genomës dhe mendjes së Homo sapiensit, që e kanë trupin e tyre dhe stilin e të jetuarit kaq unike në gjithë gjithësinë. Është i habitshëm zbulimi që evoluimi ynë është influencuar shumë nga ajo që gjenetika e popullit sot e quan “rrjedhë gjenetike” (genetic drift). Bëhet fjalë për një fenomen në zhvillim, që krijon varësi për një kohë të shkurtër me mekanizmat e një selektimi natyror, kur popullimi i një qenieje specifike përfundon në një hiç, ku anëtarët tanë e kanë eksperimentuar më shumë në kohën paleolite.

Për ta mbyllur, qenia jonë duket se është specializuar nga një shumëllojshmëri gjenetike,







shumë të thyer. Me rrjedhë gjenetike do të kuptojmë fenomenin me të cilin disa mutacioe gjenetike në një popullsi të ngushtë nuk janë seleksionuar apo eliminuar, edhe kur kanë pasur efekte të rënda, si skizofrenia, etj. Ato kanë bërë të mundur dhe zbulime mahnitëse, si zbulimet hapësinore euklidiane, ndjesinë e lartë, etj. Këto janë shembuj të zhvillimit të lobeve cerebrale dhe të kafkës së rrumbullakët (zona HAR, të cilën e përshkruam më lart).

Janë këto të reja, së bashku me kapacitete të tjera ekzistuese (do të shohim fenomenet si neuroplastika dhe neuro-rrjeti), që e kanë bërë të mundur përfshirjen e mundësisë së besimit. Kjo u paraqit si një përparësi për çështjen shoqërore të grupit dhe në kombinim me ekonominë (përgjigjja e pyetjes si të mbijetojmë), ka bërë që të përparojë linjën tonë të zhvillimit njerëzorë. Përfshirja e mundësisë morale dhe më vonë të mundësisë së besimit, -duket sikur ka ofruar një përgjigje për forma të caktuara të grupimit dhe të specifikimit në grup, e po ashtu transmetimit të geneve, përndryshe nuk do të kishin mundësi për t'u shprehur. Në këtë mënyrë, shenjat e para që specia njerëzore mundte dhe donte dalëngadalë që të largohej nga logjika brutale e seleksionimit natyrorë dhe mbijetesës së më të fortit kanë bërë që të përfshihen në evoluimin e shoqërisë. I gjithë ky proces është kulmor, në ato cilësi tipike njerëzore, falë të cilave sot mund të përfshijmë kontrollin e evoluimit tonë. Këtij argumenti autorët tonë ia kushtojnë kapitullin final.

Është interesante të vëmë re si nga shpikjet dhe nga hipotezat e këtyre studiuesve përfshihet një imazh i njerëzimit, i cili nuk është i dënuar që të përfshihet në një kuadër totalisht të ngurtë, në të cilin ajo që është një mbrojtëse ekskluzive e forcave brutale të përzgjedhjes natyrore, dhe aty ku liria do të ishte një iluzion. Autorët nënvizojnë që sinteza e nëntëqindës mes darvinizmit të tetëqindës e të trashëgimisë mendeliane, nuk është më e mjaftueshme për të shpjeguar evoluimin e karakteristikave neurokonjektive komplekse, si kapaciteti social, kapaciteti kulturorë, kapaciteti moral dhe besimtarë. Nga ana tjetër, biologët janë duke punuar për një sintezë të quajtur EES (Extended Evolutionary Synthesis), e cila nuk e zëvendëson atë antiken, por e lidh me funksionet e reja dhe konceptet, si "rastësia reciproke", mekanizma të feedback-ut mes gjenomës dhe zgjedhjes së shprehisë, selektimit të grupit, trashëgimisë jo gjenetike, etj. Këto propozime rrisin habinë tonë, para misterit që është njeriu.

### Shkenca e jetës dhe besimi

Mund edhe të konstatojmë që në këtë evoluim, dy autorët e librit, nuk takojnë asnjë teknologji, në të nuk gjendet një rastësi e domosdoshme. Për shembull, pse në ndryshim nga Homo sapiens, njeriu i neanderthalit nuk ka zhvilluar asnjëherë mundësinë e besimit, pavarësisht se që të dy vinin nga një "sulm" i përgjithshëm? Edhe pse, ndryshe nga Homo habilis, linja e evoluimit nuk ka gjetur një rrugë specifike?

Në bazë të studimeve tona të biologjisë dhe teologjisë na duket mahnitëse që mes gjithë këtyre hipotezave është përfshirë një vizion i ri i jetës dhe i besimit. Shumë, kur u kuptua që shekulli XX do bëhej shekulli i kërkimit për trurin, prisnin që të tilla distanca mund të transportoheshin në një humnerë të vërtetë. Nëse sjellja e besimtarit dhe kapaciteti për të besuar mund të përfshihen edhe si një mundësi biologjike komplekse, e cila ndihmon dhe asiston specien tonë, atëherë kjo nuk do të tingëllonte më e çuditshme për veshët e një teologu. Tradita e krishterë nënvizon që 2000 vjet, që të qenit njeri e ka lirinë që të besojë apo jo në dhuratën, në hirin, në atë çka i ofrohet, duke përfshirë këtu edhe mundësinë për të besuar dhe lirinë për të besuar apo jo.

E ç' mund të themi për rastet kur flasim ne me Zotin, pra në lidhje me teologjinë? Ajo do të influencohet nga ky prezantim i ri i njeriut? Dy studiuesit propozojnë për një përgjigje pohuese, edhe pse nuk përpiqen që të eksplorojnë mundësinë dhe nuk pretendojnë të shkruajnë teologji.

Ne dëshirojmë që të mbyllim këtë reflektim me një shënim teologjik të mirëfilltë. Pa vënë në dyshim rezultatet kërkimore biologjike bashkëkohore, do të rrisin vizionin tonë njerëzorë, dhe kjo logjikisht do të influencojë teologjinë.

Gjithnjë ka qenë kështu, e gjithë e folura e jonë që i është drejtuar Zotit, lind nga një njohje perfekte dhe ne do të vazhdojmë që të kërkojmë që t'i afrohem këtij misteri të madh, me fjalë joperfekte, megjithatë ne e bëjmë edhe me fjalë të reja, sepse realiteti ynë është në një transformim komplet.

Kështu, mund të parashikojmë që zbulimet e reja mund të bëjnë që t'i kalojnë Zotit të folurën tonë, për aq kohë sa Krijuesi ka një gjuhë që nënvizon se ai është një Krijues që ka mundësi të pafundme dhe që na mundëson në mënyrë të pandërprerë dhe në mënyrë të papritur, që gjëra të reja të lindin nga ato të vjetrat.

**Përktheu: Bernardina Shahini**

Marrë nga revista kulturore – fetare  
"La civiltà cattolica", 2020



Tiranë, 10/12/2020



**Lënda: *Komunikim mbi Emërimin e Nuncit të Ri Apostolik në Shqipëri***

Shenjtëria e Tij, Papë Françesku, në përkujtimin Liturgjik të Virgjërës Mari të Loretos, ka emëruar për Nunc Apostolik në Shqipëri, *Shkëlqesinë e Tij Imzot Luigi Bonazzi (Luigj-i Bonaci)*, deri më tani Përfaqësues Papnor në Kanada. Sh. T. Imzot Bonazzi ka lindur në Gazzaniga (Bergamo) me 19 qershor 1948. Është shuguruar meshtar me 30 qershor të viti 1973 për Dioqezën e Bergamos. Është i diplomuar në Shkencat e Edukimit. Me dt. 25 mars të vitit 1980 ka hyrë në Shërbimin Diplomatik të Selisë Shenjte dhe më vonë ka punuar pranë Përfaqësive Diplomatike në Kamerun, Trinidad dhe Tobago, Maltë, Mozambik, Spanjë, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Itali dhe Kanada. Ka qenë emëruar Nunc Apostolik në Haiti me 19 qershor të vitit 1999, në Kubë me 30 mars të vitit 2004, në Lituani dhe Estoni me 14 mars të vitit 2009 dhe në Letoni me 25 mars 2009. Dhe, në fund, Nunc Apostolik në Kanada me 18 dhjetor të vitit 2013. Fjalët e para që Sh. T., Nunci i ri Apostolik u ka dërguar të gjithë Barinjve të Kishës në Shqipëri, përpara mbërritjes së tij, janë këto:

*“... Nuk e fsheh: vij me gëzim në Shqipëri, mirënjohës Zotit që përmes Papës Françesk më bën këtë dhuratë të papritur. Dëshiroj të vij me përvujtëri, tamam sikurse ai që besimin e vet e vë në Zotin e për këtë me padurim pres t'i shoh veprat që Zoti dëshiron dhe do t'i bëjë”.*

Edhe e Barinjtë në Shqipëri, nga ana e tyre, përmes një letre, kanë shprehur mirënjohjen për Papën Françesk, për emërimin e tij, si dhe njëkohësisht i urojnë mirëseardhjen Nuncit të Ri Apostolik në Vendin tonë

**Zyra e Shtypit e KISH**



## KISHA MESJETARE SHËN BARBARËS NË PLLANË TË LEZHËS

Të nderuar, Imzot Ottavio Vitale, Imzot Angelo Massafra, kryetar i Bahkisë Lezhë Pjerin Ndreu, Ministria e Arsimit Evis Kushi, prefekti, Gjokë Jaku. Mysafirë të nderuar!

Burimet tona historike mijëvjeçare të traditave të lashta të popullit tonë, janë relativisht të pakta në numër e me zbrazëti, e sidomos për sa i përket disa periudhave të caktuara të historisë. Kjo sikurse dihet, është rrjedhim i rrethanave historike të veçanta e shpesh herë të vështira, në të cilat është ndodhur vendi ynë nga pushtuesit e ndryshëm gjatë shekujve. Për këtë arsye zbulimi, mbledhja e studimi i burimeve dokumentare ekzistuese historike, gërmime të reja, restaurimi e rikonstruktimi i objekteve fiton një rëndësi të veçantë për vendin tonë.

Monumentet kishtarë historike e kulturore të mesjetës, në vendin tonë, kanë radhe dalëngadalë duke u zhdukur e dëmtuar dhe duke u pakësuar në numër. Kanë influencuar gjatë shekujve, luftërat e shpeshta, invadimet e huaja, tërmetet etj. por, pa dyshim në dëmtimet e zhdukjen e tyre e kanë influencuar në kohërat e caktuara edhe pakujdesja e njerëzve, mungesa e rezistencës së materialeve të ndërtimit ose të pikturimit. Në shumë raste mbishkrimet e afresket janë mbuluar me suva, janë lyer me gëlqere ose është pikturuar rishtazi sipër tyre etj..

Nder burimet dokumentare historike të Kuvendit të Arbëri të vitit 1703, në veri të Shqipërisë, numërohen rreth 85 objekte kishtarë të nivelit ekselence që ishin të dëmtuar nga pushtuesit osman. Sidoqoftë, ndër këto objekte kishtarë të mesjetës në veri të Shqipërisë, me ngrehinë të plotë e më shumë gjurme të afreskeve dhe që i kanë rezistuar furtunave të egra të kohërave deri sot, janë Kisha e Balldrenit e Rubikut të shek. XII dhe kjo e Pllanës ka të ngjarë e shek. XIII, për të cilën jemi mbledhur sot. Studimi i kishave të mesjetës, konservimi i rrënojave, rikonstruktimi apo ringritja e tyre, është tepër i rëndësishëm, sepse është koha kur formësohet popullsia arbërore, sepse ato janë sot për sot, dëshmia e vetme për ta njohur më mirë, kulturën, gjuhën, historinë e popullit tonë.

Ndërtimet e kultit, duke qenë të krijuara në ndërtimin e fesë, dëshmojnë mjaft mirë aspektet të ndryshme, të zhvillimit historik, ekonomik, e shoqëror të vendit, ndaj studimi i tyre është me mjaft interes.

Ndër monumentet e kulturës shqiptare një vend të rëndësishëm zënë edhe Kisha e Pllanës, kushtuar Shën Barbarës ose (shna Barbullës siç njihet në popull) martire e shek. IV, shpallur Monument Kulture në vitin 1973.

Ky ndërtim i mesjetës, është një dëshmi materiale e shpirtërore autentike me vlera të jashtëzakonshme, për studimin e historisë arkitekturore, afreskeve të arritur deri me sot, , sajtit arkeologjik, tashmë të dëmtuar nga ndërtimi i varreve, të ndërtimit në përgjithësi dhe vet historisë së popullit tonë.

### Historiku

Kisha e Barbarës (Shën Barbulla) ndodhet në lindje të fshatit Pllanë, në Lezhë. Kisha është një ndërtim i shek XIII-XIV-të i stilit romanik dhe e shpallur Monumente Kulture në vitin 1973.

Më rastin e ndarjes së territoreve në mes vëllezërve të Dukagjinit në vitin 1368, territori i Blinishtit i Matit dhe Pllana, i takuan, Pal e Tanush Perlatit (Dukagjinit). Me rastin e pushtimit të Lezhës nga venecianët, 1393, kjo zonë u bë prone e tyre.

Në anën e jashtme kisha është trajtuar thjeshtë, ndërtuar me gurë të papunuar gëlqerorë dhe shtufi. Kisha me përmasa fillestare 16 x 27m dhe me tri absida, gjatë shekujve disa herë është shkatërruar, nga pushtuesit Osman dhe herë nga tërmetet të ndryshme që kanë goditur vendin tonë, duke u reduktuar së fundi në përmasat e sotme. Marin Bici, në vitin 1610 përmend hajatin në hyrje të kishës. Kurse Ipeshkvi Mark Skura në vitin 1640 duke e përshkruar madhësinë e saj e cilëson si një katedrale. Sipas dokumenteve të kohës, pas shkatërrimit në vitin 1669 u restaurua nga Dom Pal Bici, kurse rindërtimi i shtëpisë në 1672. Sipas ipeshkvit Nikollë Vlladanit, vitin 1694, shprehet se Kisha ishte në gjendje të mirë, më një altar të madh, një portik dhe dy altare të vegjël. Ndërsa muri rrethues i oborrit që ndërtuar në vitin 1753. Vlladani më vonë dëshmon se tërmeti 1672 Kishën e kishte shkatërruar përsëri. Tërmeti i radhës që e dëmtoi mjaft ishte i vitit 1753. Pastaj faktori njeri e shkatërroj në vitin 1787 nga rivaliteti për pushtet në mes Mehmet Bushatliut (Karamahmuti) dhe Mehmet Çaushtit. Dhe së fundi 1915, që dëmtuar rëndë nga Esadistët shqiptar.

Kisha e Shën Barbarës martire e shek. IV, ruan pikturë murore në faqen perëndimore të Naosit dhe në atë lindore të Narteksit. Piktura në Naos ruhet në anën e djathtë të hyrjes perëndimore, ajo ka gjerësi 1.8m dhe lartësi 1.95m duke filluar në lartësinë 0.45m nga dyshemeja. Piktura është realizuar në teknikën e afreskut në një support jo shumë të trashë. Skena paraqet Shën Jakobin Apostull dhe Shën Katarinën e Aleksandrisë.

Në hyrje të Kishës, detaj unik është paraqitja e dorës së 'Atit të gjithëpushtetshëm' që përfaqëson ndërhyrjen e Zotit në përcaktimin e rrjedhës së ngjarjeve nëpërmjet ndihmës hyjnore që i ofron Shën Gjergjit i cili vret dragoin dhe Shën Mëhilli Kryengjell që e mbytë vesin e keq të njeriut.

Faza e parë afreskeve duhet të jenë postbizantine të shek. XIII dhe faza e dytë shek.. XV të shkollës artistike të Adriatikut.

Në pjesën e altarit gjenden vizatime të thjeshta dekorative me motive biblike të realizuara në vitin 1941 nga ushtari italian, Bardini Renato. Objekti ka kripten, ku kanë qenë të varrosur dy ipeshkvij të zonës.





### Restaurimi

Ndërrhyrjet e fundit në këtë objekt u bënë nga Ministria e Kulturës në vitin 2001-2002, duke vendosur një çati provizore mbi atë vjetër, heqja e suvatimit të brendshëm dhe sistemimi i dyshemesë. Por përgjatë 18 viteve me radhë objekti nga moskujdesi i vazhdueshëm që degraduar tejet skajshëm.

Në këtë rast u pa i nevoja e domosdoshme e një ndërhyrje të shpejt për ta shpëtuar çfarë mund të shpëtohej. Pas sigurimit të një sasive financiare, me 19 gushtë filluam punimet në këtë objekt e që zgjaten deri në fund të dhjetorit 2020, duk përshirë këtu edhe sistemimin e ambientit për rreth dhe përkujtimoren për shkollën shqipe. Gjatë zhvillimit të punimeve u ballafaquam pos faktorit kohë vjeshte më shira që na krijonte pengesa, edhe me disa, siç shprehej prefekti Jaku “sehirxhinjë”, që “hidhnin gurin e fshihnin dorën”

Bashkia Lezhë, kryetari i saj, gjithëherë me hije të lehet dhe i buzëqeshur për të mirë, Pjerin Ndreu dhe i pazëvendësueshmi Prefekti me plotë energji pune, bir i kësaj famullie Gjokë Jaku. Fakti së nën ombrellën e kësaj Kishë edhe pse me shumë droje nga pushtuesit osman, së fundmi në vitin 1638, që ngritur shkolla shqipe, në shenjë përkujtimi për këtë ngjarje ndriçuese ngritëm pedestalin kushtuar abecesë së shqipes, fal kontributit të Drejtorit të Drejtorisë Rajonale të Arsimit, Bardhok Pulaj, afaristit Viktor Jushi dhe mendjes së mbrehtë të skulptorit, Sadik Spahia. Duhet përmendë dhe kontributin modest i pllanorëve në mërgim, si dhe disa personave jashtë fshatit të Pllanës, që u bënë pjesë e këtij projekti në forma të ndryshme. Më këtë rast duhet përmendur dhe ngritjen e bustit të Dom Pjeter Njeçit bir i kësaj famullie, financuar nga Edmond Njeçi banues në Amerikë.



qoftë nga jeta shoqërore e sidomos nga Ministria e Kulturës të cilët këta të fundit arriti që t'i disiplinonte vet kryeministri Rama.

Punimet për rikonstruktimin dhe restaurimin e Kishës u bënë më fonde private fal dashamirësve të kulturës shqiptare. Ata janë: i kudogjeturi e kudokontribuuesi, Gjergj Leqejza; atdhetari i devotshëm dhe prifti kokëllartë, Dom Anton Kçira i cili vepron në Detroit; Edmond Jakaj, mirditori që punon në Dubai dhe miku i kulturës, mjeku Ukë Berisha, nga Komuna e Klinës.

Duke kuptuar vlerat e këtij objekti historik, fetar e kulturor, shtuam gamën e punimeve përreth saj, ndërtimin e pedonales në mes të varrezave, gjelbërimit, ujësjellësin, ku duhet veçuar kontributi e pazëvendësueshëm të dhënë më shumë dashuri, nga

Njohësi i mirë u kulturës shqiptare, afaristi Gjergj Leqejza, me të cilin kemi bashkëpunuar ngushtë në ngritjen e Qendrës të poetit Ndre Mjeda në Kukël, rikonstruktimin e restaurimin në vitin e kaluar të Kishës Shën Prentes në Balldre, këto ditë në rrjetet sociale shprehej:

*Të gjithë bashke ia dolëm edhe me këtë projekt për evidentimin e vënien në dispozicion të publikut të vlerave të shumta historiko-religjioze që ka zona dhe gjithë hapësira shqiptare. Unë do shtoja se puna e jonë e përbashkët më çiltërsi dhe dashuri të të katër subjekteve, për rikthimin në identitet të këtij kompleksi, i ngjante simfonisë së Betthovenit, prandaj objekti dhe ambienti përreth mori pamjen që e kemi sot, që mund të konkurojë në tërë Shqipërinë.*

**Dom Nikë Ukgjini**



## NJË HUMANIZËM PA ZOTIN ËSHTË NJË HUMANIZËM ÇNJERËZOR!

*Përvjetori i 30<sup>e</sup> i kremtimit të Meshës së Parë  
në varrezat të Rëmajt - Shkodër*

04/11/1990 – 04/11/2020

Në këtë Kishë Katedrale, më 25 prill 1993, Papa Shen Gjon Pali II ka kremtuar meshën, në të cilën shuguroi katër ipeshkvij, ndër të cilët ishin Imzot Fran Illia dhe Imzot Zef Simoni, ipeshkvi ndihmës. Në homelinë që Papa bëri në atë meshë ka cituar pesë herë fjalët e Psalmi 118: *Kjo është dita që na e dhuroi Zoti.*

Kishte arsye të gëzohej Papa Shen Gjon Pali, duke parë këtë Kishë Katedrale, që vetëm deri tri vite më parë shoku diktator e kishte shndërruar në Pallat sporti, por tani ishte plotë me besimtarë të lumtur të pranishëm për ngjalljen e hierarkisë së Kishës së Krishtit në Shqipëri.

Të gjithë jeni në dijeni për urrejtjen e madhe që diktatori kishte ndaj Kishës Katolike, për dy arsye. Së pari, sepse, sipas tij, katolikët ishin spiunët e Vatikanit (kinse Vatikani ishte një super fuqi!). Së dyti, sepse, në vetë fjalët e tij, “katolikët, sidomos klerikët e tyre, janë më të pasur në libra, më të ngritur dhe ata, atje ku mundin vazhdojnë ta zhvillojnë fenë katolike”. Dhe, në një fjalim tjetër, tha: “Të gjithë hierarkët e kishës katolike, nga më kryesori deri te xhakoi e te famullitari, ishin të mësuar, të shkolluar me shkollë teologjike”. Si çdo diktator, ai kishte frikë nga intelektualët, dhe e dimë sa shumë intelektualët katolikë kanë ndikuar pozitivisht në kulturën e këtij vendi. Por nderi ynë i madh si Kishë Katolike është fakti se klerikët tanë kanë duruar torturat e vdekjen pa pranuar asnjë kompromis me xhelatët komunistë. Nderi ynë është fakti se nuk i jemi përgjigjur mizorisë komuniste me shpirt hakmarrjeje, por me shpirt të krishterë. I ndjeri Imzot Zef Simoni diku ka shkruar: “Ndaj atyre që më kanë arrestuar dhe burgosur s’kam asnjë detyrë tjetër përveç faljes: i fal”.

Sot po përkujtojmë atë ditë kur, para tridhjetë viteve, në kapelën e varrezave të Rëmajt, Dom Simon Jubani me disa meshtarë dhe besimtarë te guxinsëm sfiduan regjimin komunist duke kremtuar meshën e parë. Atë ditë, varrezat janë bërë dëshmitarë të varrit të Krishtit, i cili, atë ditë të ngjalljes së Jezusit, ka marrë një fizionomi të re.



Nga vendi i vdekjes u transformua në vend të ngjalljes. Atë ditë të meshës së parë, nga ato varre doli ajo këngë e këndshme: “Aleluja!”

Në homelinë që Dom Simoni bëri në atë meshë ai tha: “Asht krejt logjike që Shkodra, e cila ka bajtë peshën ma të randë, të bahet nismëtare e të thejnë akullin e lirise te fesë, që është burimi i të gjitha të mirave materiale dhe shpirtnore”. Dhe pastaj vazhdoi: “Le t’i lusim shpirtnat e burgatorit që të na ndihmojnë me rindertue gjithshka asht shkaterrue dhe fitue gjithshka kemi humbë”. Dhe sot le ta falënderojmë Zotin, sepse kjo lutje u pranua dhe sot po shohim se kërkesa që ka bërë Dom Simoni atë ditë u krye. Sigurisht, shumë prej jush keni qenë dëshmitarë duke parë se si monumente madhështore që armiqtë e Kishës kishin ndërtuar për veten tani po shkatërroheshin, ndërsa kishat që ata kishin shkatërruar po rindërtoheshin, madje po ndërtoheshin kisha të reja. Keni qenë dëshmitarë kur kjo kishë e madhe, tempull i Hyjit, vendi ku bashkohet familja e Krishtit për t’i kremtuar misteret e shenjtja, u transformua, nga armiqtë e Zotit, në një fushë sportive.

Në të njëjtën homeli në atë meshë të kremtuar tek varrezat, Dom Simoni tha: “Në ket Fush’ Rëmajit ka martirë, shejten të njoftun dhe të panjoftun”. Këto fjalë na kujtojnë martirët tanë, viktimitë të atij sistemi komunist të Enverit që nuk ishte vetëm ateist, por më i keq se kaq: ishte anti-teist, ishte me të vërtetë një luftë kundër Zotit. Por,



si ka thënë Papa Shen Pali VI, “një humanizëm pa Zotin është një humanizëm çnjerëzor, sepse pa Zotin njeriu mund ta ndërtojë botën, por në këtë rast do ta ndërtonte për shkatërrimin e vet”.

Nesër do të jetë përvjetori i katërt kur Kisha ka shpallur të Lumët 38 martirët tanë, Vinçenc Prenushi dhe shokët. 34 prej tyre ishin meshtarë (ose klerikë), tre ishin burra, besimtarë laikë, dhe një vajzë njëzet e dy vjeçare, Marie Tuci, e vrarë barbarisht 70 vjet më parë, sepse ajo ishte një katekiste, postulante me Motrat Stigmatine.

Renditur i pari në mesin e martirëve është Vinçenc Prendushi, ipeshkvi i fundit i Durrësit. Ai vdiq në burg, pasi kishte pësuar shumë tortura. Ai u akuzua si "armik i popullit", "reaksonar", "spion i Vatikanit", dhe u dënua me njëzet vjet burg, ku ai u torturua, fye dhe poshtërua në shumë mënyra të ndryshme, derisa vdiq.

Papa Shen Gjon Pali II ka deklaruar se martirizimi i krishterë "i ka shoqëruar gjithmonë dhe vazhdon të shoqërojë jetën e Kishës, edhe sot". Ai ka shkruar këto fjalë në vitin 1993, shumë kohë para lindjes të lëvizjeve anti-krishtera që janë shfaqur në këto dy dekadat e fundit.

Në shoqërinë bashkëkohore, martirizimi merr një rëndësi akoma më të madhe dhe të veçantë. Në një botë që është ushqyer nga një mentalitet i shekullarizuar, martirizimi i tregon kësaj bote se ka vlera të vërteta që e bëjnë të vlefshme sakrificën e jetës së dikujt: Motivi i këtij vetëfljimi, domethënë dashuria për Krishtin dhe për të vërtetën.

Në një fjalim të tij, Papa Shen Pali VI pyeti: "Për çfarë ka më shumë nevojë Kisha sot?" Dhe ai u përgjigj se në rrethanat e tanishme "Kisha ka nevojë për besimtarë të fortë", domethënë, për njerëz të pajisur me virtytin e guximit. Shën Pali kishte paralajmëruar tashmë të krishterët e Romës: "Mos u pajtoni me frymën e kësaj bote", që do të thotë se jeta e krishterë gjithmonë nënkupton një luftë kundër një mentaliteti të kësaj bote.

Të dashur vëllezër dhe motra, ndihuni shumë të lumtur dhe fatlumë për faktin se e keni njohur Krishtin dhe keni vendosur ta ndiqni. Shikoni dhe vlerësoni shembujt e martirëve tanë: përballë torturave dhe vdekjes nuk kanë bërë asnjë kompromis me të keqen. Edhe ju, mos lejoni kurrë të bëheni vegla në duart e atyre që sot po luftojnë për eklipsin e Zotit, për një botë pa Zotin dhe pa moral. Ja pse sot po shohim një rritje të vrasjeve, të vetëvrasjeve, të përdorimit të drogës, të vjedhjeve, të përdhunimeve të ndryshme.

Për të përfunduar më lejoni të bëj një thirrje të fortë të gjithëve, familjeve, të rinjëve dhe në veçanti atyre që janë angazhuar në politikën: sepse ngjarja e

4 nentorit 1990 nuk ka vetëm “valencë” (dhomëthënje) fetare por edhe politike:


Sot jemi këtu jo vetëm për ta përkujtuar atë ngjarje dhe për vigjiljen e festës së të Lumëve tanë Vinçenc Prennushi me Shokë Martirë, por edhe për ta shikuar të sotmen tonë dhe për ta orientuar të ardhmen tonë si fetare dhe si qytetare në Shqipëri. Po, sepse nuk mund të jetojmë vetëm me kujtimet e të kaluarës nëse kjo nuk na rrënjos mirë në të sotmen dhe nuk na projekton drejt të ardhmes.

Kjo do të thotë se ne sot, këtu dhe tani, i kemi në dorë fatet e jetës sonë, të Kombit tonë, të Kishës sonë: Martirët tanë të lumë dhe ata që na kanë paraprirë kanë qenë protagonistë të kohës së tyre dhe ecin përpara nesh si shembuj të ndritshëm të angazhimit civil dhe fetar; angazhim që na e kanë përçarur edhe neve dhe që ne e kemi marrë përsipër.

Politikanët të dashur dhe të nderuar, ju lus, në emër të kësaj dite: kërkoni jo të mirën personale ose të partisë, por të mirën e popullit tonë; jepni, pas 30 viteve, një hov më të fort në angazhimin tuaj për të shmangur çdo formë padrejtësie; bëni të çmosur që familjet tona, të rinj dhe të reja të ndihen vlerësuar dhe stimuluar për të qendruar këtu dhe për të dhënë kontributin e tyre për Shqipërinë tonë.

Jemi një popull, jemi familja e Zotit në Shqipëri. T’ia kërkojmë këto hire Zotit gjatë këtij kremtimi për ndërmjetësin të Marisë, Nënës së Këshillit të Mirë, Mbrojtëses sonë qiellore, dhe për ndërmjetësi të Martirëve të Lumë: mbrojtjes së tyre jua besoj të gjithëve ju këtu të pranishëm dhe të gjithë ata që na ndjekin përmes mediave, në veçanti të sëmurët, të rinjtë tanë, emigrantët. Amen

**Imzot Angelo Massafra OFM**







## MË 6 SHKURT TË VITIT 1967 MBYLLJA E KISHAVE E XHAMIVE

### Fjalim përshëndetës me në mbrëmje përkujtimore – kulturore

Shkodër 03/11/2020

Të nderuar të pranishëm, Ju përshëndes të gjithëve dhe ju falënderoj për praninë tuaj. Sot dhe nesër jemi duke kremtuar 30 vjetorin e Meshës së parë të kremtuar nga don Simon Jubani. Edhe në këtë moment, si kam bërë në të kaluarën, falënderoj Don Simon Jubanin, meshtarët dhe bashkëpunëtorët për atë ditë historike, për ri-fillimin e lirisë fetare dhe civile.

Hyji, Zoti i historisë, që udhëheq historinë, pas 23 vitesh, pas rrëzimit të Murit të Berlinit me 9 nëntor 1989...ka lëvizur diçka edhe në Shqipërinë tonë, dhe me 4 nëntor 1990 ndodhi mrekullia: Meshtarët, në krye Don Simon Jubani, me disa besimtarë, guximtarë e fesë, sfiduan regjimin komunist dhe u kremtua Mesha e parë në Varrezat e Rrmajt në Shkodër.



Falënderoj më Zotin, Zojën Nënë e Këshillit të Mirë dhe Martirët tanë. Dikush prej tyre e kishte profetizuar gjatë torturave: “nga nën toka, ne do të jemi më të fortë se ju” dhe “do të rindërtohen kishat që jeni duke shkatërruar”...

Të nderuar, është shumë mirë të kujtojmë këto ngjarje, por nuk mjafton...ne do të bëjmë vetës një pyetje: Çfarë kemi bërë deri tani për një

Falënderoj don Vlashin, famullitarin dhe bashkëpunëtorët për këtë mbrëmje përkujtimore – kulturore. Falënderoj kumtuesit.

Me 6 shkurt të vitit 1967 u mbyllen kishat dhe xhamitë: një pjesë e madhe u shkatërruan, një pjesë u shndërruan; u ndaluan rreptësisht kremtimet publike të riteve fetare dhe të Meshës.

Por siç e dimë të gjithë: meshtarët u betuan për të vazhduar në fshehtësi kremtimin e sakramenteve dhe të Meshës...dhe për të çuar të burgosurve Kungimin e shenjtë, ushqim i nevojshëm për të përballuar burgun, torturat dhe pushkatimin.

Me lejoni t'ju them: ndërsa në Shqipëri ishin ndaluar lutjet publike në gjuhën shqipe, në Kalabri, si më tha, Imzot Donato, Eparka i Lungros, vazhdojshinë lutjet dhe kremtimet në gjuhën arbëreshe.

Shqipëri që kemi ëndërruar në fillim të lirisë, 30 vjet më parë? A kemi dhënë kontributin e duhur? A do të japim tani kontributin tonë - nuk është kurr vonë - për të ndërtuar një Shqipëri dhe një bashkësi të krishterë me vlerat që kane përjetuar Martirët tanë: që kanë vdekur për fenë dhe atdheun, ...që janë shpallur të Lumë nga Papa Françesku me 5 nëntor 2016.

A do të mundohemi të gjithë që të jemi qytetarë të mirë, të ndershëm, që duam më shumë Vëndin tonë, duke qenë gurë të gjallë për Kishën dhe për Shqipëri?

Ky do të jetë angazhim i te gjithëve...dhe kërkojmë këto hire Zotit, Zojës Mari, Nënës e Këshillit të Mirë, Shën Nënë Terezës sonë dhe të Lumëve Martirët tanë. Amen.

*Imzot Angelo Massafra OFM*



## JUBILEU I TË LUMES MARIE TUCI

*“Falënderoj Zotin, që po vdes e lirë”*  
(Marie Tuci)

Marie Tuci është një figurë e veçantë, që përcjell një mesazh të fortë dhe domethënës për të gjithë ne. Me jetën e saj ajo dëshmoi më së miri fuqinë e fesë së krishterë, e cila nuk shuhet as në momentet më të vështira. Marie Tuci është e vetmja vajzë në listën e 38 Martirëve shqiptarë të shpallur të Lumë më 5 nëntor 2016 në Shkodër. Këtë vit 2020 kemi festuar 70-vjetorin e kalimit në amshim të Marie Tucit (1950-2020).

Shkëlqesia e Tij Imzot Angelo Massafrà O.F.M. Arqipeshkëv Shkodër-Pult dhe nga Fra Landi Jaku O.F.M., më 24 tetor 2019, i kanë dhënë fill këtij viti jubilar, gjatë të cilit, një herë në muaj, është kremtuar Mesha e shenjtë në nder të së Lumes Marie Tucit. Datat 22, 23 dhe 24 tetor 2020, Triditëshi kushtuar kësaj të Lumeje, shënojnë edhe mbylljen e këtij viti jubilar.

Më 22 tetor, në orën 08.30, është kremtuar Mesha e shenjtë nga Provinciali i Provincës Françeskane Shqiptare, Fra Aurel Gjerkaç. Menjëherë pas Meshës, është ekspozuar për adhurim i Shenjtërueshmi Sakrament, që ka vazhduar deri pasdite dhe është mbyllur me lutjen e Mbrëmësorës, në orën 16:00, udhëhequr nga Delegatja e Motrave Stigmatine, Motër Terezina Demaj.

Pasditën e datës 23 tetor është organizuar një konferencë e pasur me ligjërime, dokumentar, këngë e valle. E moderuar nga Fra Aurel Gjerkaç, Konferenca është mbajtur në kishën e Shën Bonaventurës të Motrave Stigmatine. Hapjen e konferencës e bëri Imzot Angelo Massafrà O.F.M., i cili gjatë përshëndetjes së tij i ftoi të pranishmit që të reflektonin mbi qëndresën e palëkundshme të Marie Tucit përballë armikut, qëndresë e cila duhet të na shërbejë si shembull për veprimet që bëjmë në jetën e përditshme.

Menjëherë më pas, Sekretarja e Këshillit Gjeneral të Motrave Stigmatine, Motër Dukate Radoja, prezantoi në mënyrë të përmbledhur historinë e themelimit të Institutit të Motrave Stigmatine, misionin dhe shërbimin e tyre pas vendosjes në Shqipëri.

Vijoi kënga “Martire për fe”, kënguar nga kori polifonik “Prenkë Jakova”. Më pas, Fra Giuseppe Lanzellotti O.F.M.Capp., bëri promovimin e librit: “Shërbimi amënor i mëshirës” të Atë Pier Giorgio Taneburgo O.F.M.Capp. Një moment i veçantë

ishte dëgjimi i këngës “Dashuri e patregueshme”, interpretuar nga rinia Hajmel-Nënshat. Pas këngës u shfaq dokumentari me titullin “*Falënderoj Zotin, që po vdes e lirë*”, përgatitur nga Ergys Kavaja. Konferenca u mbyll me ansamblin e “Valles së Shqipes” nga rinia e famullisë së Shën Shtjefnit Shkodër.

Ditën e fundit të këtij jubileu Mesha e shenjtë, e orës 10.00, kremtuar në kishën e Motrave Stigmatine, u udhëhoq nga Ipeshkvi i Dioqezës së Rrëshenit, Imzot Gjergj Meta, me të cilin bashkëkremtuan edhe Ipeshkvi i Dioqezës së Sapës, Imzot Simon Kulli, Fra Aurel Gjerkaç e shumë meshtarë të tjerë.

Në Meshë ishin të pranishëm edhe disa nga të afërmit e të Lumes Marie Tucit. Gjatë predikimit, Imzot Gjergji pohoi se të krishterët nuk festojnë vdekjen por jetën, feja i ka dhënë forcë Maries dhe martirëve të tjerë që të përballen me martirizimin, dhe se çdo kush e dëshmon Krishtin në jetën e përditshme është martirë.

### Motrat Stigmatine





## KRISHTI NA KA THIRRUR TI JEPTE DRITË ECJES TONË!

**Kushtet e përkohshme të Moter Mandalena Lepuri e Moter Rita Toma**

*“Sprovoni e shihni sa i mirë është Zoti! I lumi ai që shpreson në të!” (Ps 34, 9)*

Me datën 23. 11. 2020 kemi qenë vërtetë të prekura thellë dhe plot admirim përballë dashurisë së pamasë që buron nga Zemrat e Shenjta, për këtë dëshirojmë të falënderojmë Hyjin pa fund që na ka menduar nga përjetësia, i cili na thirri në ekzistencë dhe na dhuroi jetën, na dha hirin të rritemi në gjirin e një familjeje ku morëm bazat e një edukimi në fe, ku për ne filloi një udhëtim në besimin e krishterë. Nuk mjaftoj vetëm kaq, por në madhësinë e Tij të pafundme na shikoi dhe në vogëlsinë tonë na zgjodhi, duke na thirrur të jetojmë me Të dhe për Të, në këtë familje rregulltare shumë të mrekullueshme të Motrave Punëtore të Vogla të Zemrave të Shenjta. Dëshirojmë të falënderojmë Institutin që na mirëpriti, dhe u përkujdes për formimin tonë për disa vite me radhë, duke na dhënë mundësinë për të ndjekur Jezusin më nga afër. E gjithë kjo qoftë për lavdinë e Zotit. Data 23 Nëntor do shënohet në zemrat tona, ishte data ku ne përfunduam dy vitet e noviciatit, gjithashtu në këtë ditë kujtojmë ditën e kalimit në amshim të Themelueses tonë. E dëshironim shumë këtë ditë por rreth nesh ishte një sprovë e madhe ku gjithçka na dukej e mjegullt, e paqartë, realiteti i pandemisë ndaloi që të ishte e pranishme eprorja jonë e përgjithshme Nënë Giancarla Dima e cila kishte shumë dëshirë të ishte pranë nesh, njëkohësisht edhe ne dëshironim që ajo të ishte më ne, por nga pamundësia ajo delegoi përfaqësuesen e sajë këtu në Shqipëri Moter Anna Maria Moccaldi. Edhe pse gjithçka ishte e turbullt nga situata e krijuar ne nuk u dorëzuam, por ju përkushtuam lutjes dhe u besuam në Hyjin që Ai i cili na ka thirrur ti jepet dritë ecjes tonë. Po ashtu mbështetje e fortë ishte edhe lutja e të gjitha bashkëmotrave tona. Pra vetëm Hyji të pamundurën e bën të mundur e nuk na braktis kurrë, Ai i gjen të gjitha rrugët që të përmbushet vullneti i Tij. Pikërisht edhe për ne ndodhi kështu, ku përballë kësaj situatë na dha shpresën që të përmbushim atë çfarë Hyji kishte filluar. Nëpërmjet Bariut tonë Monsignor Angelo Massafra të cilin Hyji e lejojë që t'i bënë dritë ecjes dhe dëshirës tonë të madhe, për t'iu kushtuar Zotit. Pikërisht mbështja e tij atërore dhe prania e tij në këtë kremtim Eukaristik na ka inkurajuar për të realizuar atë çfarë Hyji kishte filluar dhe projektuar për ne. Mbështetja e Monsignor Angelos në kushtimin tonë do mbetet një kujtim shumë i bukur. Sidomos fjalët e tij kaq të çmuara, përmes të cilave na la një program për ecjen tonë, duke ju referuar përshpirtërisë tonë ai na

tha, gjatë jetës suaj kërkonte që të jetoni me të njëjtat ndjeshmëri që kishin Zemra e Jezusit dhe Marisë, po ashtu na ka shpjeguar në mënyrë të përmbledhur tre këshillat ungjillore, duke na thënë që me kushtin e dëgjësës duhet të ndjekim gjurmët e Jezusit i cili dëgjoi Atin, kështu edhe ne duhet të jetojmë në këtë shembull. Varfëria na bën të kemi marrëdhënie sa më të thjeshta me pasurin, dhe duhet të evitojmë lakminë, nuk do kemi asgjë personale por të kërkojmë për të mos u lidhur me gjërat, gjithmonë nën shembullin e Jezusit. Pastërtia e të kushtuarave është e kushtuar Hyjit, edhe ne të kushtuarit Hyjit, duhet të kushtohemi me dashuri e për dashuri me një koncept ungjillor. Për gjithë këtë e falënderojmë përzemërsisht Shkëlqesinë e Tij.

Të pranishëm në këtë kremtim Eukaristik për të na mbështetur me lutjen e tyre ishin bashkëmotrat tona që vinin nga Pirajt dhe Kodheli, ishin meshtarë e rregulltarë me të cilët ne bashkëpunojmë në misionin tonë. Po ashtu Familjarët e motrave dhe besimtarët. Për çdo gjë falënderojmë Hyjin që i dha kuptim jetës tonë.

“Zemrat e Shenjta të Jezusit dhe Marisë, unë ju kushtohem krejtësisht Ju. Ju ofroj jetën time, veprimet e mia dhe të gjitha mendimet e mia”. (Nënë Maria Tereza De Vincenti)

**Moter Mandalena Lepuri e Moter Rita Toma  
Motrat Punëtore të Vogla të Zemrave Shenjta**



## SHËRBESA E LEKTORATIT

Me datë 15.11.2020 në famullinë “Jezusi, Dashuria e Mëshirshme” (Boriq) gjatë meshës së shenjtë, në praninë e zv/rektorit, famullitarit dhe zv/famullitarit, motrave, seminaristëve, familjarëve të mi dhe besimtarëve, shkëlqesia e tij Mons. Angelo Massafra më dha shërbesën e lektoratit. Gjatë predikimit ipeshkvi nënvizoi rëndësinë dhe nevojën që ka kisha për persona të cilët i përgjigjen Zotit me bujari dhe pa frikë.

### Por Çfarë është kjo shërbesë?

Duke qenë se formimi në seminar parashikon disa etapa të ndryshme gjatë ecjes në rrugën e meshtarisë, pas pranimit në kler (admissio) seminaristi normalisht merr shërbesën e lektoratit e cila është e lidhur me Fjalën e Zotit. Në fakt, nëpërmjet shpalljes së Fjalës në liturgji, Krishti i ringjallur

bëhet prezent në mesin e besimtarëve. Lektorati është një shërbesë e cila jepet nga ipeshkvi nëpërmjet një lutje bekimi (normalisht gjatë meshës së Shenjtë) dhe shenja e kësaj shërbese është dorëzimi i librit të Shkrimit Shenjtë. Lektor, është ai i cili merr përgjegjësinë që të shpallë dhe të jetojë Fjalën e Zotit. Pra, bëhet fjalë për një shërbesë me detyra katekistike dhe ungjillizuese ku rol të rëndësishëm ka njohja, meditim dhe dëshmia e Fjalës së Zotit.

Falënderoj Zotin për këtë shërbesë e cila më bën të kuptoj se ashtu si apostujt edhe unë duhet ta përvetësoj, meditoj, jetoj dhe shpall Fjalën e Zotit. Kjo shërbesë është një shenjë konkrete e cila më bën ta kuptoj më shumë thirrjen që ti shërbej e ti kushtohm Krishit dhe Kishës.

**Marjan Gjinesha**



## **INAUGURIMI NË KISHËN MJESJETARE TË SHËN BARBARËS NË PLLANË TË LEZHËS**



Me 21 dhjetor 2020, në Pllanë (Lezhë) u inaugurua rikonstrukcioni i Kishës së shekullit XIII, Shën Barbara. Më prezencën Ipeshkvit të Lezhës, Mons. Ottavio Vitale, kryepeshkvit të Shkodrës, Mons Angelo Massafra, Ministres së Arsimit Evis Kushi, Prefektit të Qarkut, Gjokë Jaku, Kryetarit të Qarkut, Eduard Ndreca, donatorit kryesor Gjergj Leqeja, si dhe arkitektit të restaurimit të kishave, studiuesit, të palodhurit dhe pasionuarit, Dom Nikë Ukgjini! Ngjarje të shënuara jo vetëm për kishën, Pllanën dhe Lezhën, por për religjionin dhe shkollën shqipe.

Kjo Kishë e lashtë ka dhe simboliken e shkollës shqipe që në 1638, ku u zbulua dhe memoriali i bërë me mjeshtri nga arkitekti Sadik Spahia dhe e punuar me pasion nga Viktor Jushi.

Kryetari i Bashkisë së Lezhës u shpreh: “Fondit të turizmit fetar iu shtua dhe një diamant i lënë në harresë prej vitesh. Falenderim dhe për banorët e shkëlqyer të Pllanës dhe donatorëve në emigrim që mbështetën projektin!”

Në fjalën e tij Drejtori i Drejtorisë Rajonale, Bardhok Pulaj ndër të tjera theksoi:

“Sot është ditë e veçantë për Pllanën, Qarkun e Lezhës, por dhe për Arsimin Shqiptar. Ky obelisk që përurojmë sot, është përpjekja e parë serioze për të shkuar drejt rrënjëve të arsimit shqip. Për këtë duhet falënderuar dom Nikë Ukgjini, i cili po vijon me këmbëngulje të hedhë dritë mbi historinë tonë, ndriçimin e gjurmëve më të lavdishme të besimit fetar, por dhe të dishepujve të kulturës tonë kombëtare.

Njëherësh falënderoj kryetarin e Bashkisë Lezhe; z. Pjerin Ndreu që e ka kthyer vëmendjen seriozisht nga kultura, dija dhe zhvillimi i Arsimit, z. Gjok Jaku, birin e Pllanës që po përpiqet për gjallërimin dhe kthimin e shkëlqimit të kësaj zone me histori dhe kulture të përveçme. Z. Gjergj Leqeja që është tashmë njeriu i gjendur kudo në shërbim të kulturës dhe historisë tonë përmes donacioneve serioze. Është vetëm fillimi i nxjerrjes në dritë të gjithë trashëgimisë në fushën e dijes, arsimit, formimit shpirtëror e kulturor.

*Motër Ema*







Don Jeton Thaqi  
**PAS MËSUESIT TË  
MIRË**

*Botimet Fishta  
Lezhë, 2020*



Kolec Traboini

**LULE  
PELLAZGJIKE**

Pantheon Books  
Tiranë - Boston 2020



HASAN HASANI - PERKOLA

Mirditë e Mirditorë

*Faik Konica  
Prishtinë 2020*

**KUMBONA E SË DIELLËS**

revistë fetaro-kulturore dymujore  
e Kryedioqezës Metropolitane Shkodër-Pult

Tirazhi: 100 kopje

Çmimi: 100 lekë (Evropë: 2 Euro)

Parapagimi vjetor 600 lekë  
(Evropë: 12 Euro)

e-mail: [n\\_ukgjini@yahoo.it](mailto:n_ukgjini@yahoo.it)

Web page: [www.kishakatolikeshkoder.com](http://www.kishakatolikeshkoder.com)

Adresa: Arqipeshkvia Shkodër,  
Sheshi "Gjon Pali II"

Shtypur në Entin Botues "Gjergj Fishta" - Lezhë